



P10. Strehimi dhe shërbimet sociale

"Shërbime sociale multisektoriale, të qëndrueshme dhe të standartizuara pranë komunitetit, në mbështetje dhe fuqizim të familjes si qeliza bazë e shoqërisë"

Përmbajtja

P10. Strehimi dhe Shërbimet sociale	3
1. Hyrje	3
2. Politikat e zhvillimit	3
3. Funksionet:	4
3.1. F1.Ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.	4
3.1.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1	4
3.1.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O2	5
3.2. F2. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.	6
3.2.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O1.	6
3.2.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O2.	7
3.2.3. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O3.	10
3.2.4. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O4.	11
3.2.5. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O5.	12
3.3. F3. Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale.	12
3.3.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O1.	13
3.3.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O2.	13
3.4. F4.Në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.	13
3.4.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F4O1.	14
4. Buxheti i programit të Strehimit dhe Shërbimeve sociale	14
5. Projektet dhe aktivitetet e planifikuara për strehimin dhe shërbimet Sociale;	16

P10. Strehimi dhe Shërbimet sociale

1. Hyrje

Shkodra sot është një nga qytetet në të cilin ndodhen e funksionojnë shumë institucione e qendra sociale në mbështetje të grupeve sociale në nevojë. Përveç qendrave e institucioneve publike dhe private, tradita e njohur bamirëse shkodrane ka krijuar një klimë nxitëse e pozitive për krijimin e shërbimeve të shumta, të reja e alternative nga organizat jofitimprurëse vendase e të huaja, nga institucionet fetare dhe individë. Nevojat e mëdha të shkaktuara nga tranzicioni i tejzgjatur dhe “klima” humanitare e qytetarëve tanë kanë krijuar një rrjet mbështetjeje, shërbimesh e përkujdesi për grupet sociale më në rrezik.

Gjatë vitit 2017, janë vënë në funksion të plotë dhe është punuar për konsolidimin e qendrave komunitare “Për Familjen”. Pranë këtyre qendrave ofrohen shërbime sociale si informim, orientim, këshillim, shërbim në familje, mbështetje psikosociale, etj. Këto qendra janë ngritur në pesë lagje të qytetit dhe në njësitë administrative Dajç, Guri i zi, Shalë (Theth), Velipojë dhe qendra komunitare në Njësinë Administrative Rrethinaështë në proces.

Duke u mbështetur në shërbimet e ekzistuese, eksperiencën e krijuar dhe nevojat sociale në komunitet, Bashkia e Shkodrës synon të mbështesë zhvillimin e integruar dhe të vazhdueshëm të mirëqenies sociale të familjes si qeliza bazë e komunitetit tonë të shtrirë në të gjithë territorin.

2. Politikat e zhvillimit

Programi i shërbimeve sociale, strehimit dhe shën detit publik bazohet në pesë politika themelore :

Mbulimi sa më të plotë të territorit me Shërbime Sociale duke u harmonizuar me nevojat dhe interesat e komunitetit.

Gjithëpërfshirja, Pjesëmarrja, krijimi i Mundësive të Barabarta dhe Mosdiskriminimi për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, origjinës, minoritetit etj.:

Bashkërendimi dhe harmonizimi i aktiviteteve lokale me strategjitë dhe politikat kombëtare, me instiucionet në varësi të pushtetit qëndror, bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare:

Partneriteti i ngushtë ligjor me shoqërinë civile, organizata jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti.

Vlerësimi, planifikimi dhe siguri i kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në nevojë, përmes ofrimit të alternativave për një strehim të gatshëm, të arritshëm, të përbalueshëm dhe të përshtatshëm.

Përmirësimi i shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përmes aktiviteteve të edukimit e promovimit shëndetësor, parandalimit të sëmundjeve dhe shërbimeve të tjera shëndetësore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor

Në kuadër të ligjit nr.139/2015 “Për qeverisjen Vendore” Bashkia Shkodër ka përgjegjësinë të punojë për kryerjen e funksioneve si më poshtë. Për periudhën 2018-2020, kemi objektiva të qartë për punën tonë në përmbushjeve të detyrave funksionale. Këto objektiva janë dakordësuar me organizatat e shoqërisë Civile, Institucionet në varësi të Bashkisë Shkodër, ekspertët dhe specialistët e organizatave partnere ndërkombëtare dhe vendore me të cilat punojnë, ekspertë të Institucioneve në nivel rajonal gjatë diskutimeve për hartimin e Planit social të zonës së Shkodër.

3. Funksionet:

3.1. F1.Ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

F1.O1.Permiresimi i kushteve të banimit për shtresat në nevojë;

Situata e vlerësuar në fund të vitit 2017:

- 26 apartamente sociale të gatshme për strehimin e jetimëve që jetojnë në konviktet e shkollave të mesme dhe gratë kryefamiljare me shumë fëmijë që janë pa asnjë përkrahje.
- Është realizuar sigurimi i ujit të pijshëm dhe administrimi/kanalizimi i ujërave të zeza për rreth 150 familje të komunitetit rom dhe egjiptian që jetojnë përtej Urës së Bunës..

Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019	Situata e synuar 2020
Projektimi dhe planifikimi i ndërhyrjeve të tjera infrastrukturore me synim permiresimin e kushteve të banimit dhe të jetesës për 120 familje të komunitetit Rom&Egjiptian	Sigurimi i financimeve të nevojshme për realizimin dhe zbatimin e projekteve të përgatitura për permiresimin e infrastrukturës së kushteve të banimit dhe të infrastrukturës publike për 120 familje të komunitetit Rom&Egjiptian	Realizimi i projekteve sipas qëllimeve të përcaktuara dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së ndërhyrjeve të kryera për permiresimin e kushteve të banimit dhe infrastrukturës publike.
Sherbime integruese dhe zhvilluese për rreth 30 jetimë dhe grate kryefamiljare të akomoduar në apartamente sociale funksionale dhe në administrim të Bashkisë së Shkodrës. 26 apartamente sociale funksionale dhe në administrim për jetimët dhe grate kryefamiljare pa asnjë përkrahje.	Sherbime integruese dhe zhvilluese për rreth 30 jetimë dhe grate kryefamiljare të akomoduar në apartamente sociale funksionale dhe në administrim të Bashkisë së Shkodrës. 26 apartamente sociale funksionale dhe në administrim për jetimët dhe grate kryefamiljare pa asnjë përkrahje.	Mirë administrimi i kushteve fizike të apartamenteve sociale dhe fuqizimi socio-ekonomik i individëve dhe familjeve përfituese, me qëllim integrimin e tyre; punësimin, edukimin për krijimin e autonomisë familjare.

3.1.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1

Aktiviteti

Buxheti në mijë lekë

P10.F1.O1.A1 Projektim dhe ndërhyrje në infrastrukture me synim përmirësimin e jetesës për komunitetin rom dhe egjiptian

P10.F1.O1.A2 Shërbime integruese & zhvilluese dhe administrimi i apartamenteve sociale, të krijuar për personat e dalë nga institucionet e përkujdesit rezidencial

2,005



F1.O2. Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në nevojë, përmes ofrimit të alternativave për njëstrehim të gatshëm, të arritshëm, të përbalueshëm dhe të përshtatshëm.

Situata e vlerësuar në fund të vitit 2017:

- Bashkia e Shkodrës, gjatë vitit 2017ka miratuar Rregulloren “Për përbërjen dhe funksionimin e komisionit të strehimit në Bashkinë Shkodër”. Gjithashtu është ngritur Komisioni i strehimit i cili do të administrojë procesin e përzgjedhjes dhe të adminstrimit të apartamenteve sociale për jetimët dhe gratë kryefamiljare.
- Është kryer vlerësimi infrastrukturës së banimit dhe kostimi i ndërhyrjeve me synim përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit Rom&Egjiptian.

Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019	Situata e synuar 2020
Vlerësim në vazhdimësi dhe aplikim per pjesmarrje në programet lehtesuese qeveritare si: bonus qeraje, banesa sociale me kosto të ulët, banesa sociale me qera, banesa me kosto te ulet, apo programin e subvencionimit te interesave te kredive nga shteti. per familjet në nevoje dhe administrimi e ketij sherbimi,	Vlerësim dhe aplikim per pjesmarrje në programet lehtesuese qeveritare si: bonus qeraje, banesa sociale me kosto të ulët, banesa sociale me qera, banesa me kosto te ulet, apo programin e subvencionimit te interesave te kredive nga shteti per familjet në nevoje dhe administrimi e ketij sherbimi. Ndertimi dhe administrimi i banesave sociale per familjet në nevoje.	
Aplikimi prane qeverise dhe donatoreve potencial per nderhyrje në infrastrukture me qellim permiresimin e kushteve te jetesës per komunitetin rom dhe egjiptian.	Aplikimi prane qeverise dhe donatoreve potencial per nderhyrje në infrastrukture me qellim permiresimin e kushteve te jetesës per komunitetin rom dhe egjiptian.	Realizimi i Projekteve te aplikuara dhe potencialisht te miratuara prane qeverise dhe donatoreve potencial per nderhyrje në infrastrukture me qellim permiresimin e kushteve te banimit per komunitetin rom dhe egjiptian dhe vazhdimi i aplimeve per projekte te tjera.

3.1.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O2

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P.10.F1.O2.A1 Strehim social sipas programeve qeveritare të banesave sociale me qera, me kosto të ulët dhe trajtimi me bonus qeraje.	600
P.10.F1.O2.A2 Pergatitja e studimit te fizibilitetit mbi permiresimin e kushteve te banimit per komunitetin Rom&Egjiptian në Bashkine e Shkodres	

3.2. F2. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

F2.O1.Mbulimi sa më i plotë i territorit të Bashkisë me shërbime sociale duke u harmonizuar me interesat dhe nevojat e komunitetit.

Situata e vlerësuar në fund të vitit 2017:

- Në Bashkinë e Shkodrës tashmë ka një Plan Lokal të Veprimit në zbatim. Është shtrirë shërbimi në territorin e bashkisë së Shkodrës për identifikimin e femije në situatë rruge; Janë ofruar shërbimet për 125 femije dhe 53 familje në situatë rruge me qëllim përmirësimin e kushteve tyre të jetesës.

Situata e synuar 2018

Situata e synuar 2019

Situata e synuar 2020

Ka një PLV që zbatohet në Bashkinë Shkodër. Shtrirje e shërbimeve në territorin e bashkisë së Shkodrës për identifikimin e femije në situatë rruge. Fuqizim i familjeve të këtyre femijeve.

Ka një PLV që zbatohet në Bashkinë Shkodër. Shtrirje e shërbimeve në të gjithë territorin e bashkisë së Shkodrës ku janë identifikuar femije në situatë rruge; Fuqizimi i familjeve dhe qëndrueshmëria e shërbimeve të ofruara.

Qëndrueshmëria e shërbimeve të krijuara në të gjithë territorin e Bashkisë së Shkodrës. Fuqizimi i familjeve në vështirësi sociale dhe ekonomike. Përmirësimi i PLV dhe objektivave strategjike të tij

3.2.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O1.

Aktiviteti

Buxheti në mijë lekë

P10.F2.O1.A1 Zbatimi i Planit lokal të Veprimit për Identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge

100

F2.O2 Bashkërendimi dhe harmonizimi i aktiviteteve lokale me Strategjitë dhe politikat kombëtare, me institucionet në varësi të pushtetit qendror, bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare

Situata e vlerësuar në fund të vitit 2017:

- Bashkia Shkodër ka trajtuar mesatarisht 3700 familje (në muaj) me ndihmë ekonomike. Gjithashtu janë trajtuar 4130 persona me pagesën e paaftësisë dhe 3354 invalidë të punës që trajtohen me shtesë kempit.
- Bashkia e Shkodrës ka koordinuar dhe realizuar riorganizimin dhe funksionimin e sistemit të referimit për viktimat e dhunës në familje; 70 është numri i përfituesve.
- Nevojë për informimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për shërbimet ndaj familjes;
- 11 studente kanë zhvilluar praktiken profesionale në bashkinë e Shkodrës në përputhje me nevojat e territorit, në shërbim të komunitetit. 6 nga dega psikologjise dhe 5 nga puna sociale.
- 138 qen të rrugës janë sterilizuar dhe vaksinuar, e matrikulluar në proces kryerje.
- Karta për barazi gjinore e firmosur dhe pjesë e dokumenteve strategjike të Bashkisë së Shkodrës.

Situata e synuar 2018

Situata e synuar 2019

Situata e synuar 2020

Lehtesimi i situates ekonomike-sociale per famijet në nevoje;

Funksionimi e konsolidimi i sistemit te referimit te rasteve per viktimat e dhunes në familje. Shtrirja e sherbimeve ne territorin e Bashkise

Funksionimi dhe koordinimi i sistemit te referimit te rasteve per viktimat e dhunes në familje dhe permiresimi i situates se viktimave te dhunes në familje në territorin e Bashkise se Shkodres.

Mirë funksionimi i sistemit te referimit te rasteve per viktimat e dhunes në familje me qëllim fuqizimin e viktimave nëpërmjet koordinimit ndërinstytucional në ofrimin e shërbimeve në përputhje me nevojat e rastit.

Planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve sensibilizuese te shtrira pergjate javes se cilesuar "Java e Familjes"

Planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve sensibilizuese te shtrira pergjate javes se cilesuar "Java e Familjes"

Organizim i aktiviteteve sensibilizuese për familjen dhe rëndësinë e saj në edukimin e individit dhe shoqërisë.

Studentet zhvillojne praktiken profesionale në bashkine e Shkodres ne perputhje me nevojat e territorit, në shërbim te komunitetit

Studentet zhvillojne praktiken profesionale në bashkine e Shkodres ne perputhje me nevojat e territorit, në shërbim te komunitetit

Zhvillimi i një praktike mësimore profesionale, në pjesëmarrje në aktivitete konkrete, sipas nevojave të shërbimit social të bashkisë, në shërbim të komunitetit.

Trajtimi, sterilizim dhe vaksinimi e matrikulimi në vazhdimësi për qentë e rrugës; Projektimi dhe ndërtimi i strehezes per grumbullimin e qenve të rrugës;

Trajtimi, sterilizim dhe vaksinimi e matrikulimi në vazhdimësi për qentë e rrugës. Funksionimi dhe administrimi i strehezes per grumbullimin e trajtimin e qenve të rrugës;

Trajtimi, sterilizim dhe vaksinimi e matrikulimi në vazhdimësi për qentë e rrugës. Mireadministrimi i strehezes per grumbullimin e trajtimin e qenve të rrugës;

Hartimi, miratimi dhe zbatimi i Planit te Veprimit "Për Barazi". Buxhetim gjinor dhe me pjesëmarrje për buxhetin e bashkisë. Përditësim i të dhënave statistikore me bazë gjinore për bashkinë e Shkodrës me një vëmendje te vecantë ndaj çështjeve gjinore dhe krijimin e mundësive për barazi gjinore në punësim.

Zbatimi ne vazhdimësi i "Planit te veprimit per barazi". Buxhetim gjinor dhe me pjesëmarrje për buxhetin e bashkisë. Përditësim i të dhënave statistikore me bazë gjinore për bashkinë e Shkodrës me një vëmendje te vecantë ndaj çështjeve gjinore dhe krijimin e mundësive për barazi gjinore në punësim.

Krijimi i databaze me të dhëna statistikore me bazë gjinore. Buxhetim gjinor dhe me pjesëmarrje në buxhetin e bashkisë. Përditësimi i planit të veprimit për zbatimin e kartës evropiane për barazinë mes grave dhe burrave.

3.2.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O2.

Aktiviteti

Buxheti në mijë lekë

P10.F2.O2.A1. Ndihma ekonomike dhe PAK.

990,123

P10.F2.O2.A2. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje.

300

P10.F2.O2.A3. Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj

50

P10.F2.O2.A4. Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale dhe departamentin e infermierisë

-



P10.F2.O2.A5. Projektimi, ndërtimi i strehëzës dhe trajtimi i qenve të rrugës	1,000
P10.F2.O2.A6. Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore.	200

F2.O3.Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.

Situata e vlerësuar në fund të vitit 2017:

- Janë realizuar 13 takime konsultative, 25 organizata të shoqërisë civile kanë marrë pjesë në këto takime.
- Çdo vit, Bashkia e Shkodrës në bashkëpunim të ngushtë me institucionet dhe organizatat partnere, organizon aktivitete ndërgjegjësuese në kuader të ditës nderkombetare për të drejtat e femijeve;
- Gjatë vitit 2017 janë organizuar 4 aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuese në kuader të ditës nderkombetare për të moshuarit.
- Është organizuar aktiviteti sensibilizues në kuadër të ditës "3 dhjetori", dita nderkombëtare të personave me aftësi ndryshe;
- Është organizuar 1 (një) aktivitet sensibilizues për promovimin e Ditës Nderkombetare të femijeve. Rreth 500 është numri i pjesëmarrësve në këto aktivitete.
- Janë organizuar 6 aktivitete ndërgjegjësuese për të drejtat e grave, njohjen dhe respektimin e tyre.
- Është realizuar dhe po zbatohet marreveshja në mes Bashkisë së Shkodrës dhe Save the Children për konsolidimin e shërbimeve parandalues dhe të kujdestarisë familjare me synim parandalimin e institucionalizimit të femijeve dhe deinstitutionalizimi i femijeve.
- Janë organizuar 2 (dy) aktivitete për ndërgjegjësimin e komunitetit, institucioneve publike dhe organizatave për t'u bërë pjesë dhe për t'u përfshirë në procesin e integritit të komunitetit rom në jetën, sociale, ekonomike e kulturore.
- Zbatimi i aktiviteteve të percaktuara në marreveshjen e bashkëpunimit me organizatën "Sos, Fshatrat e Femijeve" me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për familjet në nevojë në bashkinë e Shkodrës në kuader të shtrirjes së shërbimeve komunitare
- Janë organizuar 13 Takime periodike të tryezës Konsultative

Situata e synuar 2018

Situata e synuar 2019

Situata e synuar 2020

Konsolidimi i tryezës konsultative dhe organizimi takimeve periodike, së paku 4 tryeza në vit.

Qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e tryezave konsultative

Qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e tryezave konsultative me shoqërinë civile, koordnimi i shërbimeve në territor.

Planifikimi e organizimi i aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuese për respektimin e të drejtave të femijes me pjesëmarrjen aktive të femijeve.

Planifikimi e organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese në qendrat komunitare të shtrira në territorin e bashkisë së Shkodrës për ndërgjegjësimin e të drejtave të femijeve dhe për të inkurajuar mirëkuptimin ndërmjet tyre.

Planifikimi dhe organizimi i një sërë aktiviteteve ndërgjegjësuese, të shtrira gjatë javës 16 - 20 nëntor, në bashkëpunim me institucionet dhe organizatat që në fokusin e punës së tyre kanë familjen dhe fëmijët.

Organizim i aktiviteteve informuese dhe ndergjegjesuese ne kuader te dites nderkombetare per te moshuarit.	Organizim i aktiviteteve informuese dhe ndergjegjesuese ne kuader te dites nderkombetare per te moshuarit.	Organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve sensibilizuese për moshën e tretë, sipas nevojave dhe specifikave të kësaj moshe.
Organizim i aktivitetit sensibilizues në kuadër të ditës "3 dhjetori" , dita nderkombetare për personat me aftësi ndryshe me pjesemarrje te gjere institucioneve, organizatave dhe individëve;	Organizim i aktivitetit sensibilizues në kuadër të ditës "3 dhjetori" , dita nderkombetare për personat me aftësi ndryshe me pjesemarrje te gjere institucioneve, organizatave dhe individëve;	Koordinimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese në bashkëpunim me institucionet publike dhe organizatat me qëllim integrimin e personave me aftësi ndryshe në jetën socio-ekonomike.
Organizimi dhe zhvillimi i aktivitetit sensibilizues per promovimin e Dites Nderkombetare te femijeve	Planifikojme dhe organizojme aktivitete ndërgjegjësuese dhe argëtuese për fëmijët, në çdo qendër komunitare.	Planifikojme dhe organizojme aktivitete ndërgjegjësuese dhe argëtuese për fëmijët, në çdo qendër komunitare.
Konsolidimi i sherbimeve parandaluese dhe te kujdestarise familjare me synim parandalimin e institucionalizimit te femijeve, deinstitutionalizimi i femijeve, identifikimi dhe trajnimi i familjeve te gatshme kujdestare.	Konsolidimi i sherbimeve parandaluese, deinstitutionalizimi i femijeve dhe te kujdestarise familjare me synim parandalimin e institucionalizimit te femijeve. Lista e familje kujdestare e gatshme per te ofruar sherbim alternativ perkunder institutionalizimit.	
Konsolidimi i sherbimeve parandalues dhe te kujdestarise familjare me synim parandalimin e institucionalizimit te femijeve.;	Konsolidimi i sherbimeve parandaluese dhe te kujdestarise familjare me synim parandalimin e institucionalizimit te femijeve, identifikimi dhe trajnimi i familjeve te gatshme kujdestare.	Konsolidimi i sherbimeve parandalues dhe te kujdestarise familjare me synim parandalimin e institucionalizimit te femijeve. Lista e familje kujdestare e gatshme per te ofruar sherbim alternativ perkunder institutionalizimit.
Realizimi i Marreveshjes në mes Bashkise se Shkodres dhe Shprese per Boten per vtin 2018 per krijimin dhe ofrimin e mundesive me te mira per personat qe jetojne në institucionet rezidenciale dhe gjithashtu me synim bashkepunimin në sherbime te tjera per familjet në nevoje.	Realizimi i Marreveshjes në mes Bashkise se Shkodres dhe Shprese per Boten per vitin 2019 per krijimin dhe ofrimin e mundesive me te mira per personat qe jetojne në isntitucionet rezidenciale dhe gjithashtu me synim bashkepunimin në sherbime te tjera per familjet në nevoje.	Realizimi i Marreveshjes në mes Bashkise se Shkodres dhe Shprese per Boten per vitin 2020 per krijimin dhe ofrimin e mundesive me te mira per personat qe jetojne në isntitucionet rezidenciale dhe gjithashtu me synim bashkepunimin në sherbime te tjera per familjet në nevoje.
Ndërgjegjësimi i komunitetit, institucioneve publike dhe organizatave për t'u bërë pjesë dhe për t'u përfshirë në	Ndërgjegjësimi i komunitetit, institucioneve publike dhe organizatave për t'u bërë pjesë dhe për t'u përfshirë në	Ndërgjegjësimi i komunitetit, institucioneve publike dhe organizatave për t'u bërë pjesë dhe për t'u përfshirë në procesin

proçesin e integritit të komunitetit rom në jetën, sociale, ekonomike e kulturore.	proçesin e integritit të komunitetit rom në jetën, sociale, ekonomike e kulturore.	e integritit të komunitetit rom në jetën, sociale, ekonomike e kulturore.
Zbatimi i aktiviteteve te percaktuara në marreveshjen e bashkepunimit me organizaten "Sos, Fshatrat e Femijeve" me qellim permiresimin e ofrimit te sherbimeve per familjet në nevoje në bashkine e Shkodres në kuader te shtrirjes se sherbimeve komunitare.	Zbatimi i aktiviteteve te percaktuara në marreveshjen e bashkepunimit me organizaten "Sos, Fshatrat e Femijeve" me qellim permiresimin e ofrimit te sherbimeve per familjet në nevoje në bashkine e Shkodres në kuader te shtrirjes se sherbimeve komunitare.	Zbatimi i aktiviteteve te percaktuara në marreveshjen e bashkepunimit me organizaten "Sos, Fshatrat e Femijeve" me qellim permiresimin e ofrimit te sherbimeve per familjet në nevoje në bashkine e Shkodres në kuader te shtrirjes se sherbimeve komunitare.

3.2.3. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O3.

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P10.F2.O3. A1. Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në sektorin social në Bashkinë e Shkodrës.	-
P10.F2.O3. A2. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.	50
P10.F2.O3. A4. Dita ndërkombëtare e të moshuarve.	-
P10.F2.O3. A5. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi Ndryshe, më 3 Dhjetor.	100
P10.F2.O3. A6. Dita ndërkombëtare e fëmijëve, 1 Qeshori	-
P10.F2.O3. A7. Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi	150
P10.F2.O3. A8 Bashkëpunimi me Save the Children	-
P10.F2.O3. A9 Bashkëpunimi me Fondacionin "Shpresë për botën", për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë.	-
P10.F2.O3. A10: Dita ndërkombëtare e romëve	100
P10.F2.O3. A11. Bashkëpunimi me organizatën "Sos, Fshatrat e Fëmijëve."	-

F2.O4. Gjithpërfshirja, Pjesëmarrja, krijimi i Mundësive të Barabarta dhe Mosdiskrimini për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, moshës, origjinës, minoritetit.

Situata e vlerësuar në fund te vitit 2017:

- Gjate vitit 2017, rezultojnë rreth 35 aktivitete te organizuara në marreveshje me UNDP me synim fuqizimin e komunitetit rom dhe egjiptian dhe gjithashtu krijimin e kushteve me te mira te jeteses per kete komunitet. Kanë filluar punimet per ndertimin e qendres komunitare per komunitetin rom dhe egjiptian.
- Jetimët që jetojnë në kushte të vështira socio-ekonomike, çdo fund viti, janë mbështetur nga Bashkia e Shkodrës, me një ndihmë monetare, për festat e fundvitit.

Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019	Situata e synuar 2020
Vazhdimi i aktiviteteve te planifikuara në marreveshje me synim fuqizimin e komunitetit rom dhe egjiptian dhe gjithashtu krijimin e kushteve me te mira te jeteses per kete komunitet. Venia ne funksion te plote e qendres komunitare per romet dhe egjiptianet.	Konsolidimi i shërbimeve të ofruara në qendrën dhe vazhdimësia e funksionimit të qendres.	Konsolidimi i shërbimeve të ofruara në qendrën dhe vazhdimësia e funksionimit të qendres.
Perkujdesje, lehtësim dhe permiresim te kushteve socio-ekonomike ne prag te festave te fundvitit.	Perkujdesje, lehtësim dhe permiresim te kushteve socio-ekonomike ne prag te festave te fundvitit.	Perkujdesje, lehtësim dhe permiresim te kushteve socio-ekonomike ne prag te festave te fundvitit.

3.2.4. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O4.

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P10.F2.O4.A2. Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian	-
P10.F2.O4.A3. Shpërbllim për jetimët me rastin e festave të fundvitit	400
P10.F2.O4.A4. Shërbime mbështetëse dhe riaftësuese për integrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe në sistemin edukativ	
P10.F2.O4.A5. Plani i zhvillimit lokal per komunitetin rom dhe egjiptian	

F2.O5 Përmirësimi i shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përmes aktiviteteve të edukimit e promocionit shëndetësor, parandalimit të sëmundjeve dhe shërbimeve të tjera shëndetësore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetsësor.

Situata e vlerësuar në fund te vitit 2017:

- Janë organizuar 13 tema dhe 54 takimeve informuese dhe sensibilizuese me komunitetin.

Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019	Situata e synuar 2020
Organizimi i së pakut 12 takimeve informuese dhe sensibilizuese në vit me komunitetin. Database i qendrave shëndetësore parësore të gatshme, me të dhënat aktuale dhe nevojat për ndërhyrje. Projektimi dhe përmirësimi i kushteve të qendrave shëndetësore në territor.	Organizimi i së pakut 12 takimeve informuese dhe sensibilizuese në vit me komunitetin. Projektimi dhe përmirësimi i kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor.	Organizimi i së pakut 12 takimeve informuese dhe sensibilizuese në vit me komunitetin. Projektimi, përmirësimi i kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor dhe mirëadministrimi i infrastrukturës së ndërtuar.

3.2.5. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.05.

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P10.F2.05.A1 Informimi dhe promovimi për një komunitet më të shëndeteshëm	-
P10.F2.05.A2 Projektimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor	-

3.3. F3. Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale.

F3.01. Fuqizimi i Institucioneve që ofrojnë Shërbime Sociale me orjentimin Promovimin dhe Zhvillimin e Shërbimeve Alternative.

Situata e vlerësuar në fund të vitit 2017:

- Gjatë vitit 2017 9 qendra komunitare janë ndërtuar dhe janë funksionale në Bashkinë e Shkodrës (6 në lagjet e qytetit, 1 në Dajç, 1 në Gurin e Zi, 1 në Theth, Shalë). Ngritja e dy qendrave në Velipojë, Rrethina është në proces.
- Bashkia e Shkodrës administrojnë 3 çerdhe. Nurmi i foshnjëve që frekuentojnë këto çerdhe është rreth 155 fëmijë.
- Krijimi i dhe ofrimi i Shërbimeve Alternative, ditore, emergjente me synim fuqizimin e familjeve biologjike në vështirësi socio-ekonomike dhe parandalimin e institucionalizimit për fëmijet e ketyre familjeve.

Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019	Situata e synuar 2020
Synojme konsolidimin e qendrave komunitare të krijuara, ngritjen e funksionimit të 2 qendrave të reja në dy njësi administrative Postribë, Ana e Malit dhe Bërdicë, dhe gjithashtu ngritjen e shërbimit levizës në njësi administrative Pult dhe Shosh.	Synojme konsolidimin e qendrave komunitare të krijuara dhe të shërbimit levizës. Krijimin e konsolidimit të qendrave komunitare.	Shërbime sociale komunitare "Për Familjen" të konsoliduara dhe të qëndrueshme në të gjithë territorin e bashkisë së Shkodrës.
Ofrimi i shërbimit në çerdhet për fëmijët e familjeve në Shkodër. Vlerësim i nevojave aktuale për shtimin e shërbimit për fëmijët në çerdhe. Përmirësim i shërbimit në çerdhe për fëmijët e familjeve në Shkodër. Përmirësimin e cilesisë së ushqimit dhe kujdesit ndaj fëmijëve. Rritja e sipërfaqes në funksion të shërbimit për çerdhet.	Ofrimi i shërbimit në çerdhet për fëmijët e familjeve në Shkodër. Përmirësim i shërbimit në çerdhe për fëmijët e familjeve në Shkodër. Përmirësimin e cilesisë së ushqimit dhe kujdesit ndaj fëmijëve.	Ofrimi i shërbimit në çerdhet për fëmijët e familjeve në Shkodër. Përmirësim i shërbimit në çerdhe për fëmijët e familjeve në Shkodër. Përmirësimin e cilesisë së ushqimit dhe kujdesit ndaj fëmijëve.
Krijimi dhe funksionimi i Qendres së Shërbimeve	Funksionimi i Qendres së Shërbimeve Alternative, Ditore,	Qendër për shërbimet alternative funksionale, në

Alternative, ditore, emergjente. Familje të përzgjedhura dhe të trajnuara për të ofruar shërbimin e kujdestarisë.	Emergjente dhe Familje të përzgjedhura dhe të trajnuara për të ofruar shërbimin e kujdestarisë.	shërbim të komunitetit. Lista e familje kujdestare e gatshme për të ofruar shërbim alternativ për këmbënguljen institucionale. Monitorimi i familjeve kujdestare.
--	---	---

3.3.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O1.

Aktiviteti	Buxheti i planifikuar në mijë lekë
P10.F3.O1.A1. Ngritja dhe vendosja në funksion e Qendrave Sociale Komunitare “Për Familjen”	11,530
P10.F3.O1.A2 Administrimi dhe funksionimi i Çerdheve	35,211
P10.F3.O1.A3. Shërbime Alternative për fëmijët dhe familjen	100
P10.F3.O1. A4. Nderhyrje të integruara për përfshirjen dhe integrimin socio-ekonomik të fëmijëve dhe të rinjve.	-

F3.O2 Krijimi i qendres komunitare rinore për nxitjen dhe promovimin e pjesëmarrjes aktive në formim profesional e edukim, aktivitete artistike, kulturore dhe sociale për të rinjtë e Bashkisë Shkodër.

Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019	Situata e synuar 2020
Funksionimi, konsolidimi i shërbimeve si: informim, edukim dhe trajnime profesionale pranë qendres rinore publike.	Qender rinore publike në funksion të plotë për ofrimin e shërbimeve për të rinjtë.	Qender rinore publike në funksion të plotë për ofrimin e shërbimeve për të rinjtë.

3.3.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O2.

Aktiviteti	Buxheti i planifikuar në mijë lekë	Kontributi i donatorëve
P10.F3.O2.A1 Qendra Rinore "Po të Ardhmes"	4,106	4,026

3.4. F4.Në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

F4.O1.Krijimi i fondit të dedikuar për mbështetjen e personave me AN në bashkëpunim me Shoqërië Civile.

Situata e vlerësuar në fund të vitit 2017:

- 6 shtëpi familje funksionale dhe në shërbim të PAN. Shërbimet e ofruara për PAN-të në shtëpi-familje janë përkujdes shoqëror, rehabilitim, shëndetësor, këshillim, integrim. 58 klientëve të mbështetur me shërbime;
- “Asnjë fëmijë jashtë”, aktivitete social-kulturale me qëllim gjithëpërfshirjen e fëmijëve që vijnë nga familje në veshitë sociale dhe ekonomike, që mbështetet nga Bashkia e Shkodrës.

- Qendrueshmeria dhe vazhdimesia e funksionimit të kesaj bande muzikore me synim promovimin dhe përfshirjen të fëmijëve me aftësi ndryshe në aktivitete artistiko kulturore. 30 është nr. i personave të angazhuar në bandën muzikore. 9 aktivitete janë organizuar nga banda e trupës muzikore me Aftësi Ndryshe.

Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019	Situata e synuar 2020
Qendrueshmeri e shërbimeve shtëpi - familje për personat me AN në territorin e bashkise se Shkodres dhe përmirësimi i cilësive se ofrimit të shërbimeve në përputhje me standartet kombetare.	Qendrueshmeria e shërbimeve shtëpi - familje për personat me AN në territorin e bashkise se Shkodres dhe përmirësimi i cilësive se ofrimit të shërbimeve në përputhje me standartet kombetare.	Shtëpi Familje që ofrojnë shërbime të standartizuara për personat me aftësi ndryshe, që synojnë zhvillimin dhe krijimin e kushteve optimale në përputhje me nevojat e tyre.
Planifikimi dhe organizimi i aktivitetit “Asnjë fëmijë jashtë”, si një aktivitet artistik e kulturor gjithpërfshirës me pjesëmarrje aktive të fëmijëve, për fëmijet dhe familjet e tyre. Fëmijet në performancë të tyre artistike, sjellin vlerat njerëzore, nevojat e tyre dhe problematikat kryesore.	Planifikimi dhe organizimi i aktivitetit “Asnjë fëmijë jashtë”, si një aktivitet artistik e kulturor gjithpërfshirës me pjesëmarrje aktive të fëmijëve, për fëmijet dhe familjet e tyre. Fëmijet në performancë të tyre artistike, sjellin vlerat njerëzore, nevojat e tyre dhe problematikat kryesore.	Nëpërmjet zhvillimit të aktivitetit “Asnjë fëmijë jashtë”, synojmë përfshirjen e një numri të lartë fëmijësh që vijnë nga familje në vështirësi sociale dhe ekonomike, në aktivitete sociale, kulturore, etj, me qëllim integrimin e tyre.
Qendrueshmeria dhe vazhdimesia e funksionimit të kesaj bande muzikore me synim promovimin dhe përfshirjen të fëmijëve me aftësi ndryshe në aktivitete artistiko kulturore.	Qendrueshmeria dhe vazhdimesia e funksionimit të kesaj bande muzikore me synim promovimin dhe përfshirjen të fëmijëve me aftësi ndryshe në aktivitete artistiko kulturore.	Qendrueshmeria, vazhdimesia e funksionimit të kesaj bande muzikore ku anetare janë 30 fëmijë dhe të rinj me AN dhe gjithashtu rritja e numrit të performancave nëpërmjet zhvillimit dhe mbështetjes të kesaj bande.

3.4.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F4O1.


Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P10.F4.O1.A1. Projekti “Shpresa” për personat e braktisur dhe me aftësi ndryshe;	17,385
P10.F4.O1.A2. “Asnjë Fëmijë Jashtë”	266
P10.F4.O1.A3. Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi Ndryshe”	355

4. Buxheteve të programit të Strehimit dhe Shërbimeve sociale

Për realizimin e aktiviteteve/projekteve të Strehimit dhe Shërbimeve sociale planifikohet buxheti me vlerë totale 824,513 mijë lekë ndër të cilat 94 % transferta, 4 % paga dhe sigurime shoqërore, 2 % shpenzime operative.

Tabelë 1 Planifikimi për strehimin dhe shërbimet Sociale

Programi P10	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvensioni	Transferta	Investime	Totali
Plani 2017	37,816	16,237		976,627	725	1,031,405
Plani 2018	34,929	15,876	0	1,010,300	3,026	1,064,131
Plani 2019	36,434	14,579	0	1,027,869	1,040	1,079,922
Plani 2020	37,353	14,894	0	1,049,304	750	1,102,301



Grafik 1 Planifikimi i shpenzimeve për strehimin dhe shërbimet Sociale

5. Projektet dhe aktivitetet e planifikuara për strehimin dhe shërbimet Sociale;

Nr. 01	P10.F1.O1.A1 Projektim dhe ndërhyrje në infrastrukturë me synim përmirësimin e jetesës për komunitetin rom dhe egjiptian.	Llojet e programit: P 10. Strehimi dhe Shërbimet sociale Funksioni: P10.F1.O1. Përmirësimi i kushteve të banimit për shtresat në nevojë.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Komuniteti Rom&Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës jeton në kushte të vështira ekonomike dhe sociale. Problematikat e këtij komuniteti janë edukimi, papunësia, mungesa e kujdesit shëndetësor, strehimi, integrimi urban etj., por këto problematika vështirësohen pasi ky komunitet jeton në territorin e bashkisë së Shkodrës, por nuk është i regjistruar në gjendjen civile të bashkisë së Shkodrës. Me synim ofrimin e shërbimeve për përmirësimin e kushteve tyre të jetesës, bashkia e Shkodrës ka iniciuar dhe ndërmarrë një sërë nismash të rëndësishme: Gjatë vitit 2016 Bashkia e Shkodrës ka aplikuar dhe fituar pranë MZHU projektin për rikonstruksionin e 9 banesave pranë këtij komuniteti duke siguruar kështu financimin e duhur për rikonstruksionin e 9 banesave në lagjen përtej urës, gjithashtu është aplikuar për rikonstruksionin e 35 banesave të tjera pranë këtij komuniteti. Gjatë vitit 2017 kanë përfunduar ndërhyrjet për sigurimin e ujit të pishëm dhe administrimin e ujërave të zeza. Përfituese të këtij shërbimi janë 150 familje të komunitetit përtej urës së Bunës. Në vazhdim synohet që shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm të vazhdojë edhe në vendbanimet e tjera ku jeton ky komunitet.						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i kushteve të banimit dhe të jetesës së komunitet Rom&Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës. • Projektimi i ndërhyrjeve për furnizimin me ujë të pijshëm dhe ndërtimin e kanalizimeve e sistemimin e ujrave të zeza për vendbanimet ku jeton komuniteti rom dhe egjiptian. • Përmirësimi i infrastrukturës dhe rritja e sigurisë së komunitetit • Përfshirja dhe mosdiskriminimi i tyre në shërbimet ekonomike dhe sociale publike dhe private. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komunikimi dhe informimi i komunitetit R&E për projektin për të siguruar furnizimin me uje të pishëm dhe ndërtimin e KUB e KUZ. ▪ Aplikimi i projektit pranë donatorëve të huaj dhe vendas dhe sigurimi i financimin të nevojshëm për realizimin e këtij projekti. ▪ Realizimi i projektit për sigurimin e ujit te pishëm dhe administrimin të KUB e KUZ. ▪ Sistemimi i trotuarve, mbjellja e pemëve dhe vizimi i rrugës. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> ○ Sistemi i kanalizimit dhe administrimit të ujrave të zeza i gatshëm dhe në funksion. ○ Ndërtimi i çezmave publike dhe furnizimi me ujë të pijshëm të komunitetit. ○ Infrastruktura rrugore më e sigurtë pranë komunitetit R&E. ○ Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetin rom dhe egjiptian. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Komuniteti rom dhe egjiptian				OJF, UNDP, Institucione publike të edukimit, shëndetësisë e edukimit.		
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii))						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.1	Sistemim sheshi, i kanalizimeve të ujesjellësit dhe të ujrave të zeza.		Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me
	Shuma					
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) Janar – dhjetor 2018		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik UNDP Drejtoria e Studimit Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 02	P10.F1.O1.A2 Shërbime integruese & zhvilluese dhe administrimi i apartamenteve sociale, të krijuar për personat e dalë nga institucionet e përkujdesit rezidencial dhe gratë kryefamiljare me probleme social-ekonomike, pranë Qendrës Komunitare "Për Familjen" nr 6.	Llojet e programit: P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale. Funksioni: P10.F1.O1. Përmirësimi i kushteve të banimit për shtresat në nevojë.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Gjatë vitit 2017 Bashkia Shkodër përfundoi rikonstrukcionin e plotë të banesave sociale me qera të ndërtuar pranë ish konviktit të shkollës pyjore për strehimin e kategorisë së jetimëve dhe familjeve një prindërore në situatë të vështire ekonomike – sociale, dhe është në pritje të sistemimit dhe akomodimit pranë këtyre apartamenteve përfituesit, sipas vlerësimit me pikë që do bëjë Komisioni i Strehimit dhe miratimit përfundimtar që do i bëhet listës së përfituesve nga Këshilli Bashkiak. Këto banesa sociale me qira ofrojnë kushte optimale strehimi, dhe përbëjnë një mundësi të rëndësishme në fuqizimin dhe integrimin e personave që do të sistemohen aty.</p> <p>Sfida kryesore është që nëpërmjet zbatimit të këtij projekti, të krijohet një mjedis mbështetës që do të ndihmojë dhe mbështesë për fuqizimin ekonomik, social dhe autonominë, këto shtresa vulnerabel që do të strehohen në këto banesa sociale.</p> <p>Sfidë tjetër është aspekti menaxherial dhe bashkërendues i punës në këto banesa sociale me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator si premisë e rëndësishme për fuqizimin e personave të sistemuar aty, duke synuar një përfshirje sociale më të gjërë.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i kushteve të banimit të jetimëve që jetojnë prej shumë vitesh në konviktet e shkollave të mesme në Shkodër. • Sigurimi i akomodimit të përshtatshëm të jetimëve që pas moshës 18 vjeçare largohen nga institucionet e përkujdesit rezidencial. • Mbështetja e jetimëve në përmirësimin e jetesës dhe socializimit të tyre, nëpërmjet krijimit dhe funksionimit të qendrës komunitare. • Orientimin drejt programeve të tjera të strehimit në momentin që përfituesit arrijnë një fuqizim ekonomik dhe social të konsiderueshëm. • Përmirësimi i situatës socio – ekonomike të grave kryefamiljare me shumë fëmijë. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ngritja e grupit të punës për vlerësimin e kushteve sociale e ekonomike të jetimëve që jetojnë në konvikte. ▪ Ngritja dhe vënia në funksion të qendrës komunitare me shërbime mbështetëse dhe integruese. ▪ Bashkëpunime dhe Marrëveshja me OJF, institucione publike, biznes privat, në mbështetje të përmirësimit dhe integritit social të përfituesve të këtij projekti. ▪ Ngritja e grupit menaxhues dhe administrues të banesave sociale me qira. ▪ Aplikimi, vlerësimi dhe shpallja e përfituesve sipas sistemit të pikëzimit nga Komisioni i Strehimit. ▪ Akomodimi i përfituesve në banesat sociale. ▪ Fuqizimi socio-ekonomik i përfituesve me synim arrijten e autonomisë. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> ○ Të gjithë jetimët që jetojnë në konvikte do të akomodohen në kushte të mira pranë apartamenteve sociale. ○ Jetimet pas moshës 18 vjeçare, që dalin nga institucionet e përkujdesit rezidencial do të kenë akomodim të siguruar dhe të përshtatshëm. ○ Nën kryefamiljare me fëmijë në kushte të vështira ekonomike - sociale do të kenë më shumë mundësi integrimi dhe fuqizimi ekonomik. ○ Shërbime individuale mbështetëse dhe integruese të krijuara dhe funksionale për të mundësuar integrimin e përfituesve. ○ Qendër Komunitare funksionale dhe në shërbim të komunitetit për mbështetjen, integrimin dhe fuqizimin e kategorive dhe familjeve në vashtrësi socio-ekonomike. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Jetimët që jetojnë në konvikte Jetimët që dalin nga instituconet pas moshës 18 vjeçare Gratë kryefamiljare që jetojnë në kushte të vështira ekonomike e sociale Komuniteti				Bashkia Shkodër OJF Ministria Institucionet publike në territor		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurim	Operative	Transferim Kapitale



				e		e	
A.2.1	Punonjës menaxhimi qendrës komunitare	805	690	115			
A.2.2	Uje	210			210		
A.2.3	Energjia	990			990		
	Shuma	2 005	690	115	1200		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurim e	Operative	Transferim e	Kapitale
A.2.1	Punonjës menaxhimi qendrës komunitare	821	703	118			
A.2.2	Uje	250			250		
A.2.3	Energjia	1 150			1150		
	Shuma	2 221	703	118	1400		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurim e	Operative	Transferim e	Kapitale
A.2.1	Punonjës menaxhimi qendrës komunitare	837	717	120			
A.2.2	Uje	250			250		
A.2.3	Energjia	1 150			1 150		
	Shuma	2 237	717	120	1 400		
f) Periudha e zbatimit Janar – Dhjetor 2018		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: -Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik. -Stafi i Ministrisë që mbulon fushën e strehimit. -Komisioni Strehimit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr.03	<p>P.10.F1.O2.A1 Strehim social sipas programeve qeveritare të banesave sociale me qera, me kosto të ulët dhe trajtimi me bonus qeraje.</p>	<p>Llojet e programit: P10. Strehimi dhe Shërbimet sociale</p> <p>Funksioni: P10.F1.O2. Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në nevojë, përmes ofrimit të alternativave për një strehim të gatshëm, të arritshëm, të përbalueshëm dhe të përshtatshëm.</p>
<p>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</p>		
<p>i. Situata</p>		
<p>Kërkesa për strehim social pranë Bashkisë së Shkodrës rezultoi e lartë prej shumë vitesh, kjo sipas numrit të lartë të familjeve aplikuese për përfitim në programet e strehimit social. Aktualisht në Bashkinë e Shkodrës janë të regjistruara rreth 1975 kërkesa për strehim social. Këto kërkesa janë që nga viti 2005 deri në vitin 2017. Gjatë viteve ka pasur kërkesa për forma të ndryshme të programeve të strehimit social si për banesa me kosto të ulët, banesa sociale me qira, subvencionim të interesave të kredisë apo bonus strehimi. Gjatë vitit 2017 janë realizuar disa projekte me synim lehtësimin e situatës së vështirë të strehimit për grupet më në vështirësi sociale e ekonomike. Janë në proces sistemimi, pasi të bëhet vlerësimi i aplikimeve nga Komisioni i Strehimit dhe miratimi i listës nga Këshilli Bashkiak në banesa sociale me qira, (rreth 26 banesa) për jetimë dhe familje një prindërore në situatë të vështirë ekonomiko - sociale. Njëkohësisht janë vlerësuar asetet në pronësi të Bashkisë së Shkodrës me qëllim vënien në dispozicion të projekteve për të financuar realizimin e ndërtimit të banesave për strehim social. Që në fillim të vitit 2017 kemi shpallur aplikimin për programin e bonusit të strehimit, ku aplikimet për këtë program do i nënshtrohen procesit të vlerësimit nga Komisioni i Strehimit dhe do të procedohet ashtu siç parashikon ligji për miratimin e listës së përfutuesve në Këshillin Bashkiak.</p>		
<p>ii. Synimi i projektit</p>		
<ul style="list-style-type: none"> • Lehtësimi i kushteve të strehimit për familjet e pastreha nëpërmjet harmonizimit dhe bashkërendimit më efikas të shërbimeve sociale në mbështetje të grupeve sociale më në nevojë. • Bashkërendim dhe koordinim të afërt me qeverinë qendrore për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të strehimit social me qëllim zbutjen e kësaj plaje sociale. • Vlerësimi i inventarit të aseteve e pronave të paluajtshme të Bashkisë së Shkodrës me objektiv kthimin e këtyre aseteve në banesa sociale. • Rivlerësimi i situatës dhe nevojave aktuale për strehim dhe përditësimi i listës së aplikimeve për strehim social, duke përcaktuar edhe llojin e aplikimit. • Përmirësimi i kushteve të jetesës për familjet me të ardhura të ulëta dhe të mesme që nuk mund të përballojnë blerjen e shtëpive në treg të lirë, duke përfshirë kryesisht familjet në vështirësi të theksuara socio-ekonomike. • Ofrimi i alternativave për një strehim të përbalueshëm e të përshtatshëm. • Grumbullimi i të dhënave aktuale e të sakta me qëllim hartimin e politikave efikase. 		
<p>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</p>		
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Konsolidimi i shërbimit të strehimit social pranë Bashkisë së Shkodrës. ▪ Rivlerësimi i aplikimeve të kryera në vite për strehim social me qëllim njohjen sa më të mirë e të plotë të nevojave aktuale. ▪ Përcaktimi i listës së aplikuesve për strehim social sipas llojeve të aplikimit dhe të mundësive për të përfutur, banesë me kosto të ulët, banesë sociale me qira, subvencionim e interesave të kredisë apo trajtimin me bonus qeraje. ▪ Përgatitja e projekteve për strehim social në përputhje me nevojat e komunitetit dhe listën e aseteve të Bashkisë së Shkodrës. ▪ Përgatitjen e programit afat mesëm të strehimit social në Bashkinë e Shkodrës. ▪ Forcimi i kapaciteteve në lidhje me grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave e strehimit social. ▪ Përmirësimi i qasjes në strehim të grupeve vulnerabël. ▪ Sigurimi i strehimit nëpërmjet zgjerimit e orientimit të programeve të strehimit social. 		
<p>b) Rezultatet që prisni</p>		
<ul style="list-style-type: none"> ○ Shërbim i strehimit sociale i konsoliduar dhe efektiv. ○ Informacion i plotë mbi nevojat për strehim social në Bashkinë e Shkodrës. ○ Strehimi social pjesë e shërbimeve sociale dhe e mbështetjes së familjeve në vështirësi ekonomike e sociale. ○ Projekte të strehimit social të përgatitura dhe të gatshme për financim. ○ Gjendja e pronave dhe aseteve publike të vlerësuara dhe sipas mundësive të projektuara për strehim social. 		
<p>c) Aktorët e mundshëm</p>	<p>d) Kontributet e mundshme në projekt</p>	

Individë dhe familje në vështirësi ekonomike e sociale,		Bashkia e Shkodrës Donatorë vendas e të huaj, OJF, Ministria Enti Kombëtar i Banesave ,				
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Trajtim me bonus qeraje	600			600	
	Shuma	600			600	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Trajtim me bonus qeraje	600			600	
	Shuma	600			600	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Trajtim me bonus qeraje	600			600	
	Shuma	600			600	
f) Periudha e zbatimit Janar – Dhjetor 2018		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e shërbimit social, strehimit dhe shëndetit publik Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 04	P.10.F1.O2.A2 Përgatitja e studimit të fizibilitetit mbi përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetin Rom&Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës	Llojet e programit: P10. Strehimi dhe shërbimet sociale Funksioni:P10.F1.O2. Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në nevojë,përmes ofrimit të alternativave për njëstrehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Situata e komuniteti Rom dhe Egjiptian në territorin e Bashkisë së Shkodrës është mjaft problematike. Në mënyre të vecante komuniteti Rom jeton në kushtë shumë të vështira, në baraka të cilat nuk ofrojnë anjë kusht minimal për një jetesë normale. Shumica e banesave të tyre nuk kanë ujë të pijshëm, as banjo dhe probleme të theksuara ndërtimore.</p> <p>Romët kryesisht janë të vendosur në katër kampe informale në periferi të qytetit pranë Prokurorisë, Tophanës, pranë bar-restorant Dubai dhe përtej Urës së Bunës duke arritë një popullsi prej jo më shumë se 500 banorë. Ndersa komuniteti egjiptian është më stabilë dhe jeton prej disa shekujsh në qytetin tonë dhe ndodhet kryesisht pranë Kalasë me një popullsi prej 1290 banorësh.</p> <p>Aktualisht Bashkia e Shkodrës është bërë pjesë e disa projekteve të ndryshme që po zhvillohen në mbështetje dhe fuqizim të këtyre komuniteteve në bashkëpunim me MZHU dhe me donatorë e OJF të ndryshme si UNDP, Malteser, Save the Children, Terre des Hommes, SOS, etj.</p> <p>Gjatë vitit 2017 me mbështetjen e UNDP ka filluar përgatitja e studimit të fizibilitetit, nevojat për investime në vendbanimet e komuniteteve Rom dhe Egjiptian në bashkinë Shkodër me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre. Ky studim do të udhëzojë punën e MZHU dhe bashkëpunimin e saj me institucionet shtetërore, qeverisjet lokale dhe me organizatat e komunitetit në përmirësimin e kushteve të banimit dhe të jetesës të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Shkodrës.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Përfundimi dhe publikimi i planit të fizibilitetit për zgjidhje afatgjatë të vendosjes e kushteve të banimit të komunitetit Rom&Egjiptian që banojnë në territorin e Bashkisë së Shkodrës. • Kostifikimi i këtij plani dhe përgatitja e hartimi i planeve më të detajuar për sigurimin e financimeve dhe për zbatimin e tyre. • Aplikimi për fonde për të financuar pranë qeverisë dhe donatorëve të tjerë potencial për ndërhyrje në infrastrukturë për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetin Rom&Egjiptian. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i situatës së pronësisë, infrastrukturës ekzistuese dhe nevojat për vendbanimet aktuale ku banon komuniteti Rom&Egjiptian. • Vlerësimi i aseteve infrastrukturore dhe truall në pronësi të Bashkisë së Shkodrës me synim vlerësimi i mundësisë për akomodim e ngritjen e banesave sociale për komunitetin R&E. • Analizimi i të dhënave dhe përgatitja e planit të fizibilitetit. • Përgatitja e Studimit dhe publikimi i tij. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> • Database e përditësuar për komunitetin R&E dhe kushtet e banimit të tyre. • Plani i fizibilitetit për komunitetin R&E i përgatitur dhe gatshëm për t'u zbatuar • Përmirësimi i kushteve të banimit të komunitetit R&E 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Komuniteti R&E, Banorët e Bashkisë së Shkodrës,				UNDP, OJF, Institucionet publike,		
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1						
Shuma						
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) janar – dhjetor 2018		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së shërbimeve sociale, strehimit dhe shëndetit publik Enti kombëtar i banesave Ministria e Zhvillimit Urban Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 05	<p>P10.F2.O1.A1</p> <p>Zbatimi i Planit Lokal të Veprimit për Identifikimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në Situatë Rruge</p>	<p>Llojet e programit: P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale</p> <p>Funksioni:P10.F2.O1.Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.</p>
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
<p>i. Situata</p> <p>Në kuadrin e nënshkrimit të Marrëveshjes Bashkëpunimit midis MMSR, MAS dhe MPB “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge dhe Planit Kombëtar të Veprimit “Ndhimë për Familjet dhe Fëmijët në situatë rruge”, është hartuar dhe vazhdon të zbatohet plani lokal të veprimit, ku bashkia (NJMF), ka përgjegjësinë kryesore për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve dhe koordinimin e punës ndërmjet institucioneve përgjegjëse, brenda territorit të qytetit.</p> <p>Vazhdojnë të funksionojnë skuadrat e terrenit me përfaqësues të Bashkisë Shkodër, stafi i qendrave komunitare, përfaqësues të Policisë dhe Organizatave partnere të shoqërisë civile të cilët janë trajnuar, kanë qënë dhe janë prezent në territor sipas një kalendarit të paracaktuar.</p> <p>Gjatë punës në terren janë identifikuar rreth 70 fëmijë në situatë rruge, të cilët janë të komunitetit rom dhe egjiptian. Vetëm 3 nga këto fëmijë janë të regjistruar në gjendjen civile të Bashkisë Shkodër.</p> <p>Për secilen familje të identifikuar janë ofruar ndihma në veshmbathje, ushqime, asistencë ligjore, ndërmjetësim për punësim, ndihmë ekonomike, rregjistrim i fëmijëve në shkollë dhe kopshte, monitorim për frekuentimin dhe ecurinë e fëmijëve në shkollë.</p> <p>Në zbatim të ligjit 10347 datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, Bashkia Shkodër po koordinon Mbledhjet e Grupit Teknik Multidisiplinar me përfaqësues nga të gjitha institucionet publike vendore dhe organizatat partnere ku janë diskutuar rastet për çdo familje të fëmijëve në situatë rruge.</p> <p>Gjithashtu janë hartuar plane individuale ndërhyrjeje për fëmijët në situatë rruge me qëllim mbështetjen dhe përmirësimin e situatës së këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre.</p> <p>Në kuadër të ditës ndërkombëtare të fëmijëve në situatë rruge, Bashkia e Shkodrës në bashkëpunim me organizatat partnere ka organizuar pranë qendrës komunitare “Për familjen” Nr.4, aktivitetin ndërgjegjësues me slogan “Mos Dhuro Para, Dhuro Kujdes”.</p> <p>Pjesëmarrës të këtij aktiviteti ishin institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile, që kanë si pjesë të punës së tyre mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Me synim përmirësimin e gjendjes së këtyre fëmijëve, është i rëndësishëm të vazhdoje të zbatohet plani lokal i veprimit, i cili përmban detyrat, përgjegjësitë dhe procedurat standarte për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse si dhe organizatat publike apo private të cilat punojnë me fëmijët në rrezik, për ofrimin e shërbimeve lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe përmirësimin e situatës së këtyre fëmijëve në qytetin e Shkodrës.</p>		
<p>ii. Synimi i projektit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Synojmë uljen e numrit të fëmijëve në situatë rruge në Bashkinë e Shkodrës. • Synojmë ofrimin e shërbimeve mbrojtëse dhe rehabilituese për fëmijët në situatë rruge. • Synojmë përmirësimin e situatës së fëmijëve dhe familjeve në vëshitësi të theksuar social-ekonomike në Bashkinë e Shkodrës. • Synojmë rritjen e aksesit të fëmijëve dhe familjeve për të përfituar shërbime të përkujdesit, shërbim në arsim, shëndetësi dhe punësim. • Synojmë parandalimin e fenomenit “Fëmijë në Situatë Rruge” në qendër të qytetit dhe në zonat ku është konstatuar numër i madh i fëmijëve në rruge. • Synojmë parandalimin e fenomenit “Fëmijë në Situatë Rruge” gjatë sezonit të verës në zonat ku janë të identifikuar fëmijë në situatë rruge: në zonën e plazhit të Velipojës dhe në pikën kufitare të Muriqanit. 		
<p>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Zbatimii Planit Lokal të Veprimit. ▪ Bashkëpunimi ngushtë me institucionet/strukturat përgjegjëse. ▪ Përditësimi dhe zbatimi i kalendarit për grupet e terrenit, sipas njësive administrative të bashkisë Shkodër. ▪ Puna e grupeve të terrenit në qendër të qytetit dhe gjatë sezonit të verës në Plazhin e Velipojës, në zonën kufitare të Muriqanit dhe tek kryqëzimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës. ▪ Menaxhimi i rasteve emergjente të fëmijëve në bashkëpunim me policinë, shërbimin social shtetëror, organizatat partnere etj. ▪ Organizimi punës të drejtpërdrejtë me fëmijët dhe familjen duke përfshirë këshillim dhe mbështetje. ▪ Koordinimi dhe lehtësimi i GTM për të diskutuar për çdo fëmijë të konsideruar në rrezik. ▪ Zhvillimi dhe shqyrtimi i planeve individuale të mbrojtjes dhe përkujdesjes. ▪ Mbledhje e grupeve teknike multidisiplinare për mbrojtjen e fëmijëve në rrezik. ▪ Hartimi i raporteve dhe të dhënave sipas Udhëzuesit të Procedurave për Identifikimin, Ndhimën e Menjëhershme dhe Referimin e Fëmijëve në Situatë Rruge, mbi situatën e fëmijëve në territorin e Bashkisë së Shkodrës. ▪ Informimi dhe sensibilizimi i komunitetit. ▪ Organizim i aktivitetit ndërgjegjësues në ditën ndërkombëtare kundër shfrytëzimit për punë të fëmijëve dhe ditës ndërkombëtare të fëmijëve në situatë rruge (12 qeshor dhe 12 Prilli), në bashkëpunim me institucionet publike dhe organizatat. 		
b) Rezultatet që prisni		

<ul style="list-style-type: none"> o Numri i fëmijëve në situatë rruge i zvogëluar. o Shërbime mbrojtëse dhe rehabilituese për fëmijët në situatë rruge të ngritura dhe funksionale. o Fëmijë në situatë rruge të përfshirë në sistemin e mbrotjes sociale. o Kushtet e familjeve të fëmijëve në situatë rruge të përmirësuara. o Rritje e numrit të fëmijëve që frekuentojnë sistemin arsimor. o Shërbime parandaluese mbi fenomenin "Fëmijë në Situatë Rruge". 						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Fëmijët në situatë rruge Familjet në vështirësi social-ekonomike Institucionet publike Organizatrat			Bashkia Skadrat e terrenit Organizatrat Institucionet publike Komuniteti Studentët e Universitetit të Dëpartamentit Punë Sociale dhe Psikologji			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Materiale promovionale	100			100	
	Shuma	100			100	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Materiale promovionale	100			100	
	Shuma	100			100	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Materiale promovionale	100			100	
	Shuma	100			100	
f) Periudha e zbatimit Janar –Dhjetor 2018			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, Bashkia Shkodër Administratorët Shoqërorë Kryetarët e Njësive Administrative Stafi i qendrave komunitare Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër			

<p>Nr. 06</p>	<p>P10.F2.O2.A1. Ndhimja ekonomike dhe PAK</p>	<p>Llojet e programit: Strehimi dhe Shërbimet Sociale Funksioni: P10.F2.O2.Administrimi i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore për shtresat në nevojë dhe personat me aftësi të kufizuar.</p>				
<p>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</p>						
<p>i. Situata</p>						
<p>Në zbatim të legjislacionit në fuqi për ndihmën ekonomike, pagesën për personat me aftësi të kufizuar, ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", VKM-së nr. 618, datë 07. 09. 2006, "Për përcaktimin e kritereve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", Vendimit nr. 277 datë 18.6.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbërit", bashkia Shkodër ka trajtuar me ndihmë ekonomike dhe pagesë paaftësie të gjithë personat dhe familjet në nevojë. Kështu, gjatë vitit 2017 Bashkia Shkodër ka trajtuar mesatarisht 3700 familje (në muaj) me ndihmë ekonomike. Fondi total i kësaj ndihme ka qenë 202.310 lekë. Gjithashtu për vitin 2017, janë trajtuar 4130 persona me pagesën e paaftësisë, me një fond total prej 571.352 lekë.</p>						
<p>ii. Synimi i projektit (me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitimi i grupit të synuar)</p>						
<ul style="list-style-type: none"> Identifikimi i individëve dhe grupeve në nevojë të cilët nuk mund të plotësojnë nevojat bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit e përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore, mbështetja me ndihmë e këtyre familjeve duke respektuar parimet bazë mbi të cilat funksionon skema e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore (fondi sigurohet nga shteti). 						
<p>iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)</p>						
<ul style="list-style-type: none"> Aplikimet dhe pagesat për përfitim të ndihmës ekonomike apo pagesës paaftësisë për çdo muaj, pranë bashkisë së Shkodrës. Vlerësimi i aplikimeve pas marrjes së konfirmimeve nga institucionet. Shpallja e përfituesve të ndihmës sociale dhe pagesës së paaftësisë Përditësimi i listave të përfituesve të ndihmës ekonomike dhe pagesës së paaftësisë për çdo muaj nga punonjësit e ndihmës ekonomike dhe administratorët shoqërorë. 						
<p>b) Rezultatet që prisni</p>						
<ul style="list-style-type: none"> Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave dhe familjeve në vështirësi sociale dhe ekonomike. Ndërgjegjësimi i familjeve për punësim dhe bashkëpunim me institucionin e zyrës rajonale të punësimit dhe qendrën e formimit profesional, si një mundësi më e mirë për përmirësimin e kushteve ekonomike të personave dhe familjeve. 						
<p>c) Aktorët e mundshëm</p>			<p>d) Kontributet e mundshme në projekt</p>			
<p>Familjet në nevojë. Jetimët, të cilët nuk janë në institucione. Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë. Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror, deri në çastin e punësimit të tyre. Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes ose të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes. Personat me aftësi ndryshe</p>			<p>Bashkia Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Dr. Rajonale Shërbimit Social</p>			
<p>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)</p>						
<p>Shpenzimet për çdo aktivitet 2018</p>		<p>Totali (mijë lekë)</p>	<p>Nga kjo:</p>			
			<p>Paga</p>	<p>Sigurime</p>	<p>Operative</p>	<p>Transferime Kapitale</p>
<p>A.1</p>	<p>Ndihmë ekonomike</p>	<p>212 000</p>				<p>212 000</p>
<p>A.2</p>	<p>Pagesë P.A.K</p>	<p>778 123</p>				<p>778 123</p>
<p>A.3</p>						
	<p>Shuma</p>	<p>990 123</p>				<p>990 123</p>
<p>Shpenzimet për çdo aktivitet 2019</p>		<p>Totali (mijë lekë)</p>	<p>Nga kjo:</p>			
			<p>Paga</p>	<p>Sigurime</p>	<p>Operative</p>	<p>Transferime Kapital</p>



							e
A.1	Ndihmë ekonomike	210 000				210 000	
A.2	Pagesë P.A.K	800 000				800 000	
A.3							
	Shuma	1010 000				1 010 000	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Ndihmë ekonomike	220 200				220 200	
A.2	Pagesë P.A.K	810 000				810 000	
A.3							
	Shuma	1 030 200				1 030 200	
f) Periudha e zbatimit Janar - Dhjetor 2018		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së shërbimit social, shëndetit publik dhe strehimit, stafi i zyrës së ndihmës ekonomike Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					



Nr. 07	P10.F2.O2.A2. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje.	<p>Lloji i programit; P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale</p> <p>Funksioni:P10.F2.O2 Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.</p>
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Njësitë e qeverisjes vendore, si autoritete përgjegjëse në luftën kundër dhunës në familje, kanë detyrim ligjor ngritjen dhe funksionimin e sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje. (ligji nr. 9669 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, i ndryshuar dhe VKM nr. 334, datë 17. 02. 2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit tij"). Në bashkinë e Shkodrës, në shkurt të vitit 2017, nga drejtuesit e institucioneve vendore, rajonale dhe organizatave të shoqërisë civile që veprojnë me trajtimin e rasteve të dhunës në familje, është arritur firmosja e marrëveshjes së bashkëpunimit për reformimin dhe ngritjen e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij. Në zbatim të kësaj marrëveshje gjatë vitit 2017, janë organizuar 11 takime të Grupit Teknik të Punës për trajtimin, menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.</p> <p>Gjithashtu, në kuadër të 16 ditëve të aktivizmit janë planifikuar dhe organizuar një sërë aktivitetesh sensibilizuese mbi fenomenin e dhunës në familje, ku pjesëmarrësit janë njohur me çështjet kryesore mbi dhunën (shkaqet, format e shfaqjes, pasojat, etj) dhe gjithashtu janë informuar mbi shërbimet që ofrohen në territor.</p> <p>Nëpërmjet riorganizimit dhe funksionimit të sistemit të referimit, Bashkia e Shkodrës do të koordinojë të gjitha shërbimet dhe aktivitetet që ofrohen nga institucionet dhe organizatat që veprojnë me rastet e dhunës në familje në territorin e Bashkisë së Shkodrës me synim shtrirjen e shërbimeve në territor dhe parandalimin e këtij fenomeni.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Synojmë institucionalizimin e bashkëpunimit ndër institucional në referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje. • Synojmë fuqizimin e partneritetit në drejtim të luftës kundër dhunës në marrëdhëniet familjare. • Synojmë përmirësimin e ndërhyrjes në mënyrë të koordinuar me ekipe ndër-disiplinare, për një trajtim sa më efektiv të rasteve të dhunës në familje. • Synojmë të përmirësojmë ofrimin e shërbimeve për të mbijetuarat ndaj dhunës në familje. • Synojmë shtrirjen e shërbimeve për rastet e dhunës në familje në njësitë administrative të bashkisë së Shkodrës. • Synojmë zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese në kuadër të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore. • Synojmë parandalimin e fenomenit të dhunës në marrëdhëniet familjare. • Synojmë denoncimin e dhunës nga viktimat që në herët e para që ajo mund të ndodhë, jo kur ajo bëhet sistematike. • Synojmë ofrimin e shërbimeve për të mbijetuarat e dhunës për përmirësimin e situatës tyre sociale, psikologjike, ekonomike. 		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Organizimi i tryezave periodike konsultative për funksionimin e sistemit të referimit. ▪ Zbatimi i aktiviteteve të parashikuara në marrëveshje nga të gjithë institucionet përgjegjëse. ▪ Koordinim i referimit e trajtimit të rasteve të dhunës në familje dhe aktiviteteve të organizuara nga institucionet dhe organizatat mbi këtë fenomen. ▪ Planifikimi, organizimi dhe koordinimi i aktiviteteve sensibilizuese në kuadër të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore. 		
b) Rezultatet që prisni		
<ul style="list-style-type: none"> ○ Fuqizimi i sistemit të referimit të rasteve të dhunës në familje, në territorin e bashkisë Shkodër. ○ Përmirësimi i ndërhyrjes së koordinuar në identifikimin, mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje ○ Përmirësimi i shërbimeve që ofrohen në territorin e bashkisë Shkodër për viktimat e dhunës në familje ○ Ndërgjegjësim dhe sensibilizim i viktimave të dhunës në familje për denoncimin e dhunës të ushtruar ndaj tyre ○ Parandalim i fenomenit dhunë në familje ○ Zhvillim i aktiviteteve gjatë ditëve të aktivizmit me pjesëmarrje aktive të komunitetit, institucioneve publike dhe organizatave. ○ Ndërgjegjësim i komunitetit. 		
c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt	
Familjet, viktimat e dhunës Komuniteti Institucionet publike OJF-të	Bashkia, Policia, Gjykata, Përmbartimi, Prokuroria, Spitali, Zyra Rajonale e Punësimit, Drejtoria Rajonale Arsimore, Drejtoria Shëndetit Publik, Shërbimi Social Rajonal, Mjekësia ligjore, Organizatat.	



e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me
A.1	Materiale Promocionale	300			300	
	Shuma	300			300	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me
A.1	Materiale Promocionale	300			300	
	Shuma	300			300	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me
A.1	Materiale Promocionale	300			300	
	Shuma	300			300	
f) Periudha e zbatimit Janar – Dhjetor 2018		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i Drejtorisë së Shërbimit Social, Strehimit dhe Shëndetit Publik. Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				



Nr. 08	P10.F2.O2.A3 Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj	Llojet e programit: P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale Funksioni:P10.F2.O2 Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.			
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:					
i. Situata					
<p>Në Ditën Ndërkombëtare të Familjes në gjithë botën organizohen aktivitete në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, që kanë në fokus familjen, duke e përqëndruar vëmendjen tek proceset shoqërore, ekonomike dhe demografike që prekin familjet. Gjithashtu fokusi i kësaj dite është promovimi i vlerave të familjes, nxitja e barazisë midis grave dhe burrave në familje, mbrojtja e familjes si njësi bazë e shoqërisë dhe mundësia për të ndihmuar familjet për të përbushur përgjegjësinë e tyre për komunitetin ku bëjnë pjesë.</p> <p>Në territorin e bashkisë së Shkodrës, ekziston një numër i madh familjesh në vështirësi të theksuara sociale e ekonomike. Situata në të cilën ndodhen këto familje vjen si shkak i ndikimit të një sërë faktorësh si: niveli i ulët arsimor, kulturor, ekonomik, etj. Për pasojë të faktorëve të lart përmendur, këto familje shpesh herë kanë mungesë informacioni, nuk marrin interesim për shërbimet sociale që ofrohen në territor dhe jetojnë në kushte ekstreme varfërie.</p> <p>Duke qënë se Bashkia e Shkodrës që nga viti 2016, arriti ngritjen dhe vënien në funksion të qendrave komunitare të quajtura "Për Familjen", duke parë familjen si qeliza bazë për zhvillimin e komunitetit, në vitin 2017 në kuadër të ditës ndërkombëtare për familjen janë organizuar një sërë aktivitete të shtrira përgjatë gjithë javës, e cila u quajt "Java e Familjes". Aktivitetet janë planifikuar dhe organizuar për të gjitha moshat; për fëmijët, të rinjtë, gratë e burrat dhe moshën e tretë. Aktivitetet janë shtrirë në qendrat komunitare, në pedonalet e qytetit, në institucionet rezidenciale, etj. Këto aktivitete kanë patur impakt shumë pozitiv në komunitet dhe për këtë synojmë që në vitet në vazhdim të shtrijmë aktivitetet ndërgjegjësuese, mbi rëndësinë e familjes dhe ndikimit të saj në zhvillimin e individit për një komunitet të shëndetshëm.</p>					
ii. Synimi i projektit					
<ul style="list-style-type: none"> • Ndërgjegjësimi dhe informimi i komunitetit nëpërmjet takimeve sensibilizuese në kuadër të ditës ndërkombëtare për familjen, në njësitë administrative të bashkisë së Shkodrës. • Informimi i komunitetit për shërbimet që ofrohen në Qendrat Komunitare "Për Familjen", në çdo lagje të qytetit të Shkodrës. • Shtrirja e shërbimeve ndërgjegjësuese në Njësitë Administrative të Bashkisë së Shkodrës. 					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Planifikimi i kalendarit të aktiviteteve në bashkëpunim me partnerët publikë dhe privatë. ▪ Organizimi, koordinimi dhe zhvillimi i aktiviteteve sipas kalendarit të përcaktuar. ▪ Organizimi i takimeve me pjesëmarrje aktive të komunitetit. ▪ Përgatitje e materialeve promocoinal e ndërgjegjësuës mbi shërbimet për familjen. ▪ Pjesëmarrje në median vizive dhe sociale. 					
b) Rezultatet që prisni					
<ul style="list-style-type: none"> ○ Informimi i komunitetit ○ Ndërgjegjësimi i komunitetit ○ Rritje e numrit të përfituesve ○ Përmirësimi i cilësisë së jetës për familjet në vështirësi social –ekonomike ○ Familje të informuara dhe mbështetura e të integruara në jetën sociale. 					
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt			
Komuniteti Institucionet publike OJF-të		Bashkia Institucionetpublike OJF-të Bizneset private Komuniteti			
e) Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:		
			Paga	Sigurime	
			Operative	Transferime	
			kapitale		

A.1	Materiale promociionale	50			50		
	Shuma	50			50		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Materiale promociionale	50			50		
	Shuma	50			50		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Materiale promociionale	50			50		
	Shuma	50			50		
f) Periudha e zbatimit (kurfillon, kurpëfundon) Prill – Maj 2018			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit publik. Organizatrat partnere Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				



Nr. 09	P10.F2.O2.A4. Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale dhe departamentin e infermierisë	Lloji i programit; P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale Funksioni:P10.F2.O2 Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata (Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)						
Në universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", në degët e psikologjisë, punës sociale, fizioterapisë dhe infermierisë, çdo vit regjistrohen rreth 50 studentë në secilën degë. Në vitin e tretë të studimeve bachelor, gjatë gjithë vitit akademik, studentët zhvillojnë lëndën e "Praktikumit". Një lëndë e tillë është me shumë rëndësi për përfitimin e njohurive praktike në fushat përkatëse. Gjithashtu pas përfundimit të studimeve në ciklin bachelor, ka shumë rëndësi praktika e njohurive të marra gjatë viteve të studimit. Për këtë gjatë vitit 2017 Bashkia e Shkodrës ka arritur një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", ku pjesë e kësaj marrëveshje ka qënë bashkëpunimi për ofrimin e një praktike sa më profesionale dhe të vlefshme për zhvillimin akademik e profesional të studentëve. Gjatë vitit 2017, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik kanë zhvilluar praktikën 11 studentë të punës sociale dhe psikologjisë. Këto studentë janë njohur me punën dhe shërbimet që ofrohen në qendrat komunitare dhe gradualisht janë bërë pjesë aktive duke dhënë kontributin vullnetar pranë këtyre qendrave. Një eksperiencë e tillë ka rezultuar shumë pozitive për të dyja palët. Nëpërmjet institucionalizimit të këtij bashkëpunimi, studentët ofrojnë ofrojnë njohuritë e tyre në shërbim dhe në përputhje me nevojat e komunitetit, duke filluar kështu të fitojnë aftësitë bazë të profesionit tyre.						
ii. Synimi i projektit (me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitimi i grupit të synuar)						
<ul style="list-style-type: none"> • Në partneritetit me departamentin e psikologji-punë sociale dhe departamentin e infermieri-fizioterapisë, synojmë të bashkërendojmë punën për mbulimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale ndaj familjeve në nevojë. • Synojmë informimin për shërbimet në territor dhe përmirësimin e kushteve sociale të familjeve në nevojë, duke ofruar shërbimin në komunitet, në bashkëpunim me studentët. • Synohet kryerja e detyrimeve të praktikës mësimore të studentëve në mënyrë më efektive. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerri për të prodhuar rezultate)						
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Thirrja për studentët ▪ Pranimi i kërkesave nga studentët dhe universiteti ▪ Përzgjedhja e studentëve ▪ Përgatitje dhe trajnim i studentëve për punën që do zhvillojnë ▪ Supervizim i studentëve në komunitet ▪ Ndihmë për familjet në vështirësi social-ekonomike ▪ Krijimi i aftësive praktike të studentëve si profesionistë të ardhshëm 						
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)						
<ul style="list-style-type: none"> ○ Bashkëpunim i afërt bashki – universitet - student ○ Ofrim i shërbimeve në territor ○ Informim, orientim, këshillim për individët dhe familjet në vështirësi soc-ekonomike ○ Përmirësim i kushteve social-ekonomike të familjeve në nevojë ○ Zhvillim i aftësive praktike të studentëve të universitetit të Shkodrës. 						
c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)				d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)		
Studentët Universiteti i Shkodrës Komuniteti Bashkia				Bashkia Universiteti i Shkodrës Studentët		
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1						
Shuma						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga		Transferime	kapitale



			Sigurime	Operative		
A.1						
	Shuma					
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1						
	Shuma					
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) janar - dhjetor 2018		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së shërbimit social dhe strehimit Departamenti i psikologji – punë sociale Departamenti i infermierit – fizioterapisë Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 10	P10.F2.O2.A5. Projektimi, ndërtimi i strehëzës dhe trajtimi i qenve të rrugës.	Llojet e programit: P10. Strehimi dhe shërbimet sociale Funksioni:P10.F2.O2. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Kafshët e braktisura në rrugë në mënyrë të veçantë qentë, përbëjnë një problem mjaft të madh për Bashkinë e Shkodrës dhe banorët. Qentë endacakë po bëhen gjithnjë e më shumë një shqetësim publik. Rritja e numrit të tyre ka sjellë edhe rritjen e rasteve të sëmundjeve zoonotike, të cilat përbëjnë një rrezik serioz për shëndetin e popullsisë. Vlen të theksohet gjithashtu se qentë endacakë janë mbartësit kryesorë të sëmundjeve që vijnë nga parazitët. Edhe pse është e vështirë të bësh një bilanc të saktë të numrit të kafshëve të braktisura në zonat urbane, supozohet që ky numër të jetë afërsisht 700-800 qen. Gjatë vitit 2017 është zhvilluar një projekt në të cilin janë trajtuar, vaksinuar, sterilizuar, matrikulluar dhe dehelmintizuar 138 qenë të rrugës. Aktualisht nuk ekziston një qendër për grumbullimin, trajtimin dhe kujdesjen ndaj tyre, ndaj është shumë e rëndësishme ndërtimi dhe vënia në funksion e një Strehëze. Strehëza do të luajë rolin e një qendre, e cila do të funksionojë për ofrimin e shërbimeve veterinarë si vaksinimi, sterilizim/kastrimi, dehelmintizimi dhe kafshët do të jenë nën kujdesin konstant të mjekëve veterinarë, grupimeve të vullnetarëve dhe studentëve, si dhe njëkohësisht do të shërbejë për aktivitete të ndryshme me programe orientimi mbi punën vullnetare si dhe formimin profesional veterinar.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Sterilizimin, matrikulimin dhe trajtimin e qenve të rrugës. • Vaksinimin dhe dehelmintizimin e tyre • Vënie në zbatim të një plani veprimi për largimin nga rruga dhe grumbullimin e qenve endacake në një ambient të sigurtë dhe të kufizuar, 		



iii. Aktivitetet kryesore të projektit

- Grumbullimi i qenve të rrugës, sterilizimi, vaksinimi, dehelmintizimi, matrikulimi dhe trajtimi i tyre.
- Grumbullimi, largimi nga rruga e qenve endacakë dhe vendosja e tyre në ambient të përshtatshëm.
- Sigurimi i ambientit të përshtatshëm për grumbullimin dhe trajtimin e qenve të rrugës.

Kostot e Projektit të Investimit

	Totali	Investimi	Projektim
Kosto e zbatimit	763.5	763.5	
Kosto supervizim	10.4	10.4	
Kosto kolaudim	6.8	6.8	
Kosto e projektimit	19.3		19.3
Kosto Totale e Projektit - 000/lekë	800	780.7	19.3

b) Rezultatet që prisni

- Reduktimi i numrit të qenve endacakë dhe përmirësimi i situatës problematike të krijuar nga ato qytetin e Shkodrës, ulja e rrezikshmërisë ndaj tyre dhe ajo që është më e rëndësishme përmirësimi i shëndetit publik.
- Rritja e sigurisë publike, si një nevojë e domosdoshme për mbajtjen nën kontroll të situatës problematike që ato shkaktojnë.
- Përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies së komunitetit.

c) Aktorët e mundshëm

Komuniteti

d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Shkodër
OJF-të
Donator privatë
Biznesi

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Trajtimi i qenve të rrugës	200			200		
A.2	Projektimi, rikonstruksioni për strehëzën për qentë e rrugës	800					800
	Shuma	1 000			200		800
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Kapjen dhe transportimi i qenve të rrugës,	154			154		
A.2	Sterilizimi & kastrimi	528			528		
A.3	Vaksinimi / Dehelmintizimi	99			99		
A.4	Matrikulimi / regjistrimi / trajtimi	17			17		
A.5	Mirëmbajtja e strehëzës së përkohshme	202			202		
	Shuma	1 000			1000		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Kapjen dhe transportimi i qenve të rrugës,	154			154		
A.2	Sterilizimi & kastrimi	528			528		
A.3	Vaksinimi / Dehelmintizimi	99			99		
A.4	Matrikulimi / regjistrimi / trajtimi	17			17		



A.5	Mirëmbajtja e strehëzës së përkohshme	222			222		
	Shuma	1 020			1 020		
f) Periudha e zbatimit janar – dhjetor 2018		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë shërbimeve sociale, strehimit dhe shëndetit publik Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					



Nr. 11	P10.F2.O2.A6. Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore.	Lloji i programit; P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale Funksioni:P10.F2.O2. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Barazia e grave dhe burrave përbën një të drejtë themelore për të gjithë dhe një vlerë thelbësore për çdo demokraci. Për t'u arritur kjo e drejtë, duhet që ajo jo vetëm të njihet me ligj, por edhe të zbatohet me efektivitet në të gjitha sferat e jetës: politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Me gjithë rastet e shumta të njohjes zyrtare dhe përparimin e bërë, barazia e grave dhe burrave në jetën e përditshme ende nuk është bërë realitet. Gratë dhe burrat nuk gëzojnë të drejta të njëjta në praktikë. Ende vazhdojnë të ekzistojnë pabarazitë shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore. Këto pabarazi janë rezultat i disa nocioneve shoqërore të ndërtuara mbi bazën e stereotipave të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, mjetet e komunikimit, në botën e punës, në organizimin e shoqërisë. Janë aq të shumta fushat e jetës në të cilat mund të veprohet, përmes përdorimit të një qasjeje të re dhe realizimit të ndryshimeve strukturore. Për këtë, Bashkia e Shkodrës, në vitin 2017 ka realizuar nënshkrimin e kartës evropiane për barazi gjinore, duke u renditur në 4 bashkitë e para në Shqipëri që ka ndërmarrë një nismë të tillë. Në zbatim të kësaj, Bashkia e Shkodrës ka filluar procesin e hartimit të planit vendor gjinor për marrjen e hapave konkretë dhe ndërhyrjet e bashkisë në arritjen e barazisë gjinore dhe gjithashtu buxhetimin gjinor.						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Të luftojmë vazhdimësinë dhe riprodhimin e pabarazive. • Të promovojmë një shoqëri me të vërtetë të barabartë. • Të ndërmarrim veprime konkrete në favor të barazisë së grave dhe burrave. • Të marrim parasysh plotësisht përmasën gjinore në politikat, organizimin, dhe në praktikat e tyre të punës. • Mbajtin parasysh të këndvështrimit gjinor në hartimin e politikave, metodave dhe instrumenteve që ndikojnë në jetën e përditshme të popullatave vendore. • Të hartojmë plane dhe programe veprimi për barazinë, së bashku me mjetet dhe burimet financiare e njerëzore të nevojshme për zbatimin e tyre. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)						
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore e nënshkruar në Mars të vitit 2017. ▪ Hartimi, miratimi dhe zbatimi i Planit të Veprimit Gjinor, që parashtron përparësitë, veprimet dhe burimet që do të përdoren për arritjen e barazisë gjinore në jetën vendore. ▪ Bashkëpunimi me të gjitha institucionet dhe organizatat në territorin e bashkisë, me synimin për të nxitur arritjen e një barazie të vërtetë në praktikë. ▪ Buxheti gjinor ▪ Mbledhja dhe administrimi i të dhënave statistikore me fokus në çështjet gjinore. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> ○ Plane dhe programe veprimi, të mbështetura me burimet e duhura, si instrumente të nevojshme për çuarjen përpara të barazisë së burrave dhe grave. ○ Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të qeverisjes vendore. ○ Planifikimi i buxhetit të bashkisë duke u mbështetur gjithashtu në këndvështrimin gjinor. ○ Të dhëna statistikore mbi çështjet e pa/barazisë gjinore. ○ Planifikimi i ndërhyrjeve në koordinim të nevojave dhe mundësive në territor. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Komuniteti Bashkia Organizatrat Institucionet publike				Komuniteti Bashkia Organizatrat Institucionet publike		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018				Totali (mijë lekë)	Nga kjo:	
					Paga	Sigurime
					Operative	Transferime
					Kapitale	
A.1	Materiale promocionale	100			100	
A.2	Refreshments	100			100	
Shuma		200			200	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019				Totali	Nga kjo:	

		(mijë lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Materiale promovionale	100			100		
A.2	Refreshments	100			100		
	Shuma	200			200		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Materiale promovionale	100			100		
A.2	Refreshments	100			100		
	Shuma	200			200		
f) Periudha e zbatimit Janar – Dhjetor 2018		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i Drejtorisë Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik Organizatat partnere Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 12	P10.F2.O3.A1 Tryeza konsultative me organizatat që vepronë në sektorin social në Bashkinë e Shkodrës		Llojet e programit: P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale Funksioni:P10.F2.O3 Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.			
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata (Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)						
Në qytetin e Shkodrës, ndodhen e funksionojnë një sërë organizatash të shoqërisë civile që ofrojnë shërbim në mbështetje të grupeve sociale në nevojë; fëmijëve, të rinjve, grave e burrave, personave me aftësi ndryshe, komunitetit rom dhe egjiptian, moshës së tretë, etj. Viti 2016 ishte një vit i rëndësishëm i fillimit të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionalizimit të partneritetit me to. Ndërsa gjatë vitit 2017 është konsoliduar aktiviteti i tryezave konsultative dhe zhvillimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile; janë realizuar 13 takime konsultative me pjesëmarrjen e 25 organizatave të shoqërisë civile. Tryezat konsultative janë organizuar për konsultimin e Planit të Zhvillimit për komunitetin lokal rom dhe egjiptian, për Ditën Ndërkombëtare të Familjes, Kancerin e gjirit, konsultimin e projekt buxhetit, miratimin e rregullores për strehimin social, etj. Tashmë ka një proces të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të konsultimit përmes takimeve ku qëllimi i këtyre tryezave ka qenë ndërhyrja e integruar në ofrimin e shërbimeve, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe mbulimi i territorit me shërbime.						
ii. Synimi i projektit (me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitimi i grupit të synuar)						
<ul style="list-style-type: none"> • Synojmë konsolidimin e tryezave konsultative me pjesëmarrjen e shoqërisë civile. • Synojmë të integrojmë dhe koordinojmë shërbimet që ofrohen në territor. • Synojmë të përmirësojmë situatën e familjeve në vështirësi social -ekonomike të qytetit të Shkodrës nëpërmjet bashkëpunimit institucion – organizatë – biznes privat - komunitet. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)						
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përgatitja e kalendarit të aktiviteteve për zhvillimin e tryezave konsultative. ▪ Zhvillimi i tryezave konsultative. ▪ Zbatim dhe koordinimi i punës, sipas tematikave dhe nevojave, produkte të takimeve konsultative ▪ Propozime të reja për ofrimin e shërbimeve sociale sipas nevojave të territorit. 						
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)						
<ul style="list-style-type: none"> ○ Bashkëpunim i afërt dhe partneritet bashki – OJF – institucione publike – biznes privat – komunitet. ○ Shpërndarje më e mirë e shërbimeve në territor ○ Informacion mbi projektet dhe shërbimet që zbatohen në qytet ○ Përmirësim i situatës së familjeve në nevojë në qytetin e Shkodrës 						
c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)			d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)			
Komuniteti Institucionet publike Organizatave			Bashkia Organizatave Institucionet publike Komuniteti			
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1						

	Shuma						
<p>f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) janar - dhjetor 2018</p>	<p>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së shërbimit social, shëndetit publik dhe strehimit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër</p>						

<p>Nr. 13</p>	<p>P10.F2.O3.A2</p> <p>Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.</p>	<p>Llojet e programit: P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale</p> <p>Funksioni:P10.F2.O3 Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.</p>
---------------	--	---



N.14	P10.F2.O3.A4 Dita ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve	Llojet e programit: P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale Funksioni:P10.F2.O3 Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
20 Nëntori Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve synon të promovojë mirëqenien e fëmijëve, të parandalojë çdo formë dhune apo abuzimi ndaj Fëmijëve. Në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve Bashkia Shkodër, në bashkëpunim me organizatat partnere kanë organizuar aktivitete për ndërgjegjësimin e komunitetit mbi të drejtat e fëmijëve dhe mbi mundësitë dhe shërbimet që ofrohen në territor.						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Synojmë organizimin e aktiviteteve informuese, ndërgjegjësuese, orientuese për komunitetin dhe rritjen e numrit të përfituesve të shërbimeve që ofrohen në territorin e Bashkisë me synim zbatimin e të drejtave të fëmijëve. Synojmë rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimin e komunitetit mbi të drejtat e fëmijëve dhe respektimin e tyre. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Planifikimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese në bashkëpunim me partnerët publikë dhe privatë. Organizimi aktiviteti sensibilizues Bashkëpunim me institucionet publike, OJF-të, bizneset private dhe komunitetin 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi i aktivitetit Bashkëpunim i ngushtë me institucionet dhe organizatat dhe komunitetin. Ndikim në parandalimin e fenomeneve sociale (dhuna në familje, shfrytëzimi, neglizhimi, abuzimi i fëmijëve) 						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Komuniteti Institucionet publike OJF-të Bizneset private ASHMDF			Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve Institucionet publike OJF-të ASHMDF Bizneset private			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Katering për pjesëmarrësit i përgatitur nga bizneset sociale	50			50	
	Shuma	50			50	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Katering për pjesëmarrësit i përgatitur nga bizneset sociale	50			50	
	Shuma	50			50	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Katering për pjesëmarrësit i përgatitur nga bizneset sociale	50			50	
	Shuma	50			50	
f) Periudha e zbatimit Tetor - Nëntor 2018			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik. Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër			

Nr. 14	P10.F2.O3.A4 Dita ndërkombëtare e të moshuarve	Llojet e programit: P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale Funksioni: P10.F2.O3 Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i. Situata							
<p>Dita Ndërkombëtare e të Moshuarve është një ditë e veçantë për personat e moshës së tretë në të gjithë botën. Pleqëria është një prej rregullave të pandryshueshme të krijimit dhe një nga periudhat e rëndësishme të ciklit të jetës. Diskutimet janë përqëndruar në tema të tilla si: plakja e popullsisë dhe ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat e kësaj moshe, puna vullnetare, kujdesi social dhe gjetja e mënyrave sa më përfshirëse për personat e moshuar, në fuqinë punëtore.</p> <p>Një problem shqetësues në vendin tonë është ndryshimi i dinamikave brenda familjes shqiptare, ku si pasojë e ndryshimeve dhe zhvillimeve social-ekonomike, kulturore, etj, fëmijët kanë prirje për të jetuar vetëm, për të emigruar dhe për t'u shkëputur nga familja. Një ndryshim i tillë në konceptin dhe traditën e familjes shqiptare, ka bërë që të kemi një rritje të të moshuarve që jetojnë vetëm, pa përkujdesjen dhe vëmendjen e nevojshme.</p> <p>Nuk ka të dhëna mbi numrin e saktë të të moshuarve që jetojnë në territorin e bashkisë së Shkodrës. Një pjesë e madhe e kësaj kategorie jetojnë në shtëpi, vetëm, shpesh pa përkujdesje të veçantë dhe në varfëri e në kushte shumë të papërshtatshme.</p> <p>Gjatë vitit 2017 në kuadër të ditës ndërkombëtare të të moshuarve janë organizuar aktivitete të ndryshme pranë qendrave komunitare "Për Familjen". Në këto aktivitete është prezantuar dhe diskutuar mbi problematikat e nevojat e kësaj moshe dhe gjithashtu në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetit Publik për të moshuarit janë realizuar matjet e tensionit dhe glicemisë në gjak.</p>							
ii. Synimi i projektit							
<ul style="list-style-type: none"> • Synojmë organizim dhe zhvillim të aktiviteteve sensibilizuese, në kuadër të ditës ndërkombëtare të të moshuarve, duke bashkëpunuar me të gjitha institucionet publike dhe organizatat që veprojnë në qytetin e Shkodrës. • Synojmë rritjen e numrit të vullnetarëve dhe kontribimi nga ana e tyre në përmirësimin e cilësisë së jetës të shtresës së tretë. • Synojmë ndërgjegjësimin e komunitetit për krijimin e mundësirave dhe hapësirave të nevojshme për moshën e tretë. 							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Thirrje për bashkëpunim institucioneve publike dhe organizatave. ▪ Organizim i aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese por jo vetëm. ▪ Propozimi i mënyrave për përfshirje aktive të të moshuarve në shoqëri. ▪ Përfshirja e vullnetarëve në ndihmë të moshës së tretë. ▪ Kujdesi social ndaj moshës së tretë. ▪ Diskutimi i mundësive për ofrim të shërbimeve në shtëpi, për të moshuarit që jetojnë vetëm. ▪ Bashkëpunimi me institucionet publike, organizatat, biznesin privat dhe komunitetin për krijimin e mundësive në përmirësim të nevojave të tyre. 							
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)							
<ul style="list-style-type: none"> ○ Aktivitet gjithëpërfshirës, për nga diversiteti i institucioneve, organizatave pjesëmarrëse dhe komunitetit. ○ Sensibilizim i komunitetit dhe institucioneve. ○ Përmirësim i cilësisë së jetës për të moshuarit e bashkisë së Shkodrës. 							
c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)			d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)				
Komuniteti Institucionet publike DSHP OJF-të			Bashkia Institucionet publike DSHP OJF-të Bizneset private Komuniteti				
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
A.1			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
Shuma							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
A.1			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale



	Shuma						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:					
		Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale	
A.1							
	Shuma						
f) Periudha e zbatimit (kurfillon, kurpërfundon) shtator – tetor 2018		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së shërbimeve sociale, shëndetit publik dhe strehimit. Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 15	P10.F2.O3.A5 Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi Ndryshe, më 3 Dhjetor.	Llojet e programit: P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale Funksioni:P10.F2.O3 Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Në kuadër të “3 Dhjetorit” ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi Ndryshe janë organizuar aktivitete ndërgjegjësuese në bashkëpunim me institucionet publike, organizatat, donatorët, si dhe nga vetë përfituesit, me qëllim integrimin e personave me AN në jetën, sociale, ekonomike e kulturore të zhvilluara në territorin e Bashkisë së Shkodrës.</p> <p>Në territorin e Bashkisë së Shkodrës PAN ndihen të përjashtuar jo vetëm për shkak të aftësive tyre ndryshe, por edhe për shkak të barrierave fizike që ekzistojnë në insitucionet publike dhe private.</p> <p>Për këtë është me rëndësi organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese, sensibilizuese për PAN-të për t'i dhënë mundësinë këtij target grupi të shfaqin aftësitë e tyre në prezantimin e punimeve të realizuara nga vetë ata, në mënyrë që komuniteti t'i vlerësojë dhe t'i konsiderojë si pjesë e rëndësishme e shoqërisë.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Synojmë ndërgjegjësimin e komunitetit, institucioneve publike dhe organizatave, por edhe të përfituesve për t'u bërë pjesë dhe për t'u përfshirë në procesin e integritit të personave me aftësi ndryshe në jetën, sociale, ekonomike e kulturore. • Përfshirjen e personave me Aftësi Ndryshe në jetën sociale. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Aktivitet sensibilizues ▪ Panair me punime nga vetë PAN. ▪ Performacë e Bandës muzikore të PAN ▪ Organizim i aktivitetit social – kulturore nga fëmijët e qendrës kulturore/nxënësit e shkollave. ▪ Hapje e Qendres së Zhvillimit me aktiviteteve dhe pjesmarrje të OJF e komunitet. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> ○ Ndërgjegjësimi i komunitetit, institucioneve dhe organizatave ○ Zhvillimi i aktivitetit social – kulturor me pjesëmarrjen e PAN-ve dhe fëmijëve të qendrës kulturore dhe nxënësve të shkollave. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Personat me aftësi ndryshe Komuniteti; Institucionet publike; OJF-të				Bashkia Institucionet publike; Shkolla “3 Dhjetori”, Qendra e Zhvillimit, Qendra Kulturore e Fëmijëve, OJF-të; Bizneset private; Komuniteti		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	(Katering) Aktivitet sensibilizues	100			100	
Shuma		100			100	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	(Katering) Aktivitet sensibilizues	100			100	
Shuma		100			100	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	Katering Aktivitet sensibilizues	100			100	
Shuma		100			100	

<p>f) Periudha e zbatimit Nëntor – Dhjetor 2018</p>	<p>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik Stafi i Qendrës së Zhvillimit Organizatat Qendra Kulturore e Fëmijëve DAR</p> <p>Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër</p>
--	---

Nr. 16	P10.F2.O3.A6 Dita ndërkombëtare e fëmijëve, 1 Qershori	Llojet e programit: P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale Funksioni:P10.F2.O3 Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Një Qershori është dita ndërkombëtare e fëmijëve. Këtë ditë fëmijët e të gjitha moshave kërkojnë që të jenë të lumtur e të festojnë me familjen, me prindërit, me vëmendjen dhe përkujdesjen e nevojshme për realizimin e dëshirave tyre. Është dita kur vetë fëmijët ngrenë zërin për të drejtat e tyre, por në ndryshim nga të rriturit, protesta e tyre bëhet me lojra festive.</p> <p>Kjo ditë përveç se është një ditë festive, duhet të jetë një ditë sensibilizimi për promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.</p> <p>Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Institucionet publike, organizatat partnere për ditën ndërkombëtare të fëmijëve kanë zhvilluar aktivitete të larmishme sociale, kulturore, sportive dhe panairë me punime artistike nga vetë fëmijët e Institucioneve të përkujdesjes sociale në Shkodër.</p> <p>Zhvillimi i këtyre aktiviteteve kanë si qëllim të rrisin vëmendjen në drejtim të mirëqenies së fëmijëve.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Informimi dhe sensibilizimi i komunitetit për njohjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve. • Organizimin dhe zhvillimin e aktivitete sensibilizuese, në kuadër të ditës ndërkombëtare të fëmijëve, duke bashkëpunuar me të gjitha institucionet publike dhe organizatat që veprojnë në qytetin e Shkodrës. • Nxitjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në aktivitete sensibilizues dhe argëtuese. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Thirrje për bashkëpunim institucioneve publike dhe organizatave. ▪ Organizim i aktiviteteve social kulturore dhe promovuese për të drejtat e fëmijëve në ditën ndërkombëtare të fëmijëve ▪ Propozimi i mënyrave për përfshirjen e fëmijëve në vendimmarrje. ▪ Zhvillimi i aktiviteteve informuese dhe sensibilizues me fëmijët dhe prindër në qendrat komunitare "Për Familjen", takimeve. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> ○ Aktivitet social kulturor i realizuar në bashkëpunim me institucionet publike dhe organizatat partnere. ○ Sensibilizim i komunitetit dhe institucioneve për respektimin e të drejtave të fëmijëve. ○ Njohje dhe respektim të të drejtave të fëmijëve nga komuniteti dhe institucionet publike e private. ○ Përmirësim i kushteve të jetës për fëmijët dhe familjet e tyre. 						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Fëmijët Komuniteti Institucionet publike OJF-të			Bashkia Institucionet publike OJF-të Bizneset private Komuniteti			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1						
Shuma						
f) Periudha e zbatimit Maj – Qershor 2018			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik. Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër			

Nr. 17	P10.F2.O3.A7 Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi	Llojet e programit: P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale Funksioni: P10.F2.O3 Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>8 Marsi njihet si "Dita e Gruas", në të gjithë botën. Në këtë ditë reflektohet mbi kurajon dhe veprimet e grave të thjeshta të cilat luajtën një rol të rëndësishëm në historinë e të drejtave të grave. Në Ditën Botërore të Gruas, në ditët e sotme, ashtu si në të shkuarën, punohet për barazinë gjinore të gruas, pavarësinë e saj, eliminimin e padrejtësive politike, për kushte më të mira pune dhe jetese. Për herë të parë 8 Marsi në Shqipëri u kremtua në vitin 1942 të shekullit të XX-të në grupe të vogla grash.</p> <p>Gjatë vitit 2017, u planifikuan dhe organizuan një sërë aktivitesh ndërgjegjësuese, në kuadër të ditës ndërkombëtare të gruas si një ditë e veçantë për të folur mbi të drejtat e gruas, si të drejta themelore të njeriut, për arritjen e barazisë gjinore. Në këtë koncept, gjatë vitit 2017 janë organizuar 6 aktivitete ndërgjegjësuese për të drejtat e grave, njohjen dhe respektimin e tyre. Rreth 65 ka qenë numri i pjesëmarrësve në këto aktivitete. Aktivitetet janë shtrirë në cdo qendër komunitare, gjatë gjithë javës së 8 Marsit dhe rezultatet në diskutime dhe pjesëmarrje aktive kanë qenë shumë pozitive, aspekt i cili duhet ndjekur dhe vazhduar gjatë cdo viti me synim për të ndikuar kështu në ndryshimin e mentalitetit për respektimin e të drejtave të grave. Pjesë e fushatës sensibilizuese kanë qenë gjithashtu kartolinat "Mania Card" të cilat janë shpërndarë në të gjithë qytetin, transmetimi i spotit televiziv dhe transmetimi i këngës së përgatitur nga artistët e Shkodrës me titull "Ti je Grua"</p>						
ii. Synimi i projektit (me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitim i grupit të synuar)						
<ul style="list-style-type: none"> • Synojmë të ndërgjegjësojmë komunitetin e Shkodrës, në ditën ndërkombëtare të gruas, si një ditë proteste dhe jo feste. • Synojmë të ndikojmë në traditën e krijuar në qytet, mbi 8 marsin, nuk është një ditë feste, por është një ditë ndërkombëtare ku lobohet fuqishëm për të drejtat e gruas dhe jo vetëm. • Synojmë përfshirjen e meshkujve (të rinj, intelektualë) në aktivitete dhe kësaj dite. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerri për të prodhuar rezultate)						
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mbledhja e tryezës konsultative për të diskutuar mbi organizimin e aktiviteteve në ditën ndërkombëtare të gruas. ▪ Organizim takimesh ndërgjegjësuese pranë Qendrave Komunitare "Për Familjen". Në këto aktivitete kushtohet vëmendje pjesëmarrjes së barabartë gjinore, për të diskutuar mbi të drejtat njerëzore, barazinë, situatën sociale në bashkinë e Shkodrës, çfarë mund të bëjmë më tej, etj. ▪ Transmetimi i spotit televiziv me mesazhe sensibilizuese. ▪ Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve promocionale për ndërgjegjësimin e mbarë komunitetit, në ditën ndërkombëtare të gruas. ▪ Bashkëpunim i ngushtë me median, institucionet publike, organizatat, biznesin privat dhe komunitetin. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> ○ Sensibilizimi i komunitetit për të drejtat e gruas. ○ Pjesëmarrje aktive e komunitetit (meshkuj dhe femra) në aktivitete ndërgjegjësuese. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Komuniteti Institucionet Organizatat Muzikantët e bashkisë së Shkodrës				Bashkia Organizatat Institucionet Komuniteti		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime e kapitale
A.1	Materiale promocionale (baner, kartolinat mania card, etj)	150			150	
Shuma		150			150	



Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Materiale promovionale (baner, kartolinat mania card, etj	150			150		
	Shuma	150			150		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Materiale promovionale (baner, kartolinat mania card, etj	150			150		
	Shuma	150			150		
f) Periudha e zbatimit shkurt – mars 2018			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së shërbimit social, strehimit dhe shëndetit publik Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 18	P10.F2.O3.A8 Bashkëpunimi me Save the Children	Llojet e programit: P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale Funksioni: P10.F2.O3 Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Në zbatim të VKM 89 datë 26. 01 2012 në Bashkinë Shkodër është i ngritur dhe funksionon komisioni multidisiplinar i kujdestarisë, i cili shqyrton kërkesat e familjeve kujdestare dhe vendos caktimin e fëmijës pa kujdes prindëror në familje kujdestare. Qëllimi i këtij shërbimi është zgjerim i i formave alternative në strukturat rezidenciale për fëmijët drejt deinsitucionalizimit të shërbimeve të përkujdesjes. Sistemimi i fëmijëve në familjen kujdestare organizohet dhe mbikqyret nga Bashkia nëpërmjet komisionit multidisiplinar të kujdestarisë.</p> <p>Sigurimi i mbrojtjes shoqërore për fëmijët pa kujdes prindëror dhe i të drejtave të tyre janë sfida për Bashkinë e Shkodrës, por edhe për shoqërinë civile, duke kërkuar një vëmendje më të veçantë për këtë target grup. Gjatë vitit 2017 Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Save the Children kanë realizuar një sërë aktivitetesh dhe trajnimesh në zbatim të programit të mbrotjes së fëmijëve. Është realizuar në bashkëpunim me organizatat partnere ngritja e një baze të dhënash për të gjithë përfituesit e shërbimeve sociale dhe e ofruesve të shërbimeve. Është ngritur dhe funksionon një strukturë, specialist në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale për kujdesin alternativ ku Save the Children ka mbuluar shpenzimet e pagës për vitin 2016, ndërsa 75% të pagës për vitin 2017 dhe 50% të pagës e parashikuar për vitin 2018.</p> <p>Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Save the Children ka mundësuar materiale promociionale për kujdesin alternativ (spot televiziv dhe radiofonik, city light, banera, postera dhe fletëpalosje). Gjithashtu janë përfshirë në projektin për fuqizimin e familjes 20 familje të cilat rrezikojnë humbjen e kujdesit prindëror. Gjatë vitit 2017 janë identifikuar 15 familje të mundshme kujdestare dhe është në proces vlerësimi i këtyre familjeve.</p> <p>Janë realizuar një sërë trajnimesh me stafet e institucioneve që ofrojnë shërbime sociale dhe shërbime të përkujdesit social për fushën e mbrotjes së fëmijëve dhe kujdesit alternativ. Gjithashtu në zbatim të kësaj marrëveshje është aplikuar modeli i shkollës komunitare për integrimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian në kopshte dhe shkolla nëpërmjet ofrimit të shërbimit të transportit dhe subvencionit të ushqimit në kopësht.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Synojmë krijimin e mundësive dhe zbatimin e të drejtës themelore të fëmijëve për të jetuar e rritur në një ambient të përshtatshëm familjar, qoftë kjo familja biologjike apo familja kujdestare. • Rritjen e njohurive e aftësive profesionale të specialistëve të punës sociale pranë institucioneve vendore e për fëmijë më synim propovimin dhe zhvillimin e shërbimeve alternative si alternativa më e mirë se institucionet rezidenciale. • Nxitjen dhe promovimin në opinionin publik ndaj shërbimeve alternative ne përgjithësi dhe vecanerisht ndaj shërbimit të kujdestarisë familjare. • Synojmë rregullimin e marrëdhënieve institucionale midis Bashkisë Shkodër dhe Save the Children për zbatimin e programit të bashkëpunimit në mbështetje të të drejtave të fëmijëve për mbijetesë, mbrojtje e zhvillim. 		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve për vlerësimin e nevojave të grupeve në nevojë dhe ndërtimin e planeve të ndërhyrjes. ▪ Ndërtimi i mekanizmave monitorues të cilësisë së shërbimeve duke ngritur kapacitetet e tyre në matjen e indikatorëve të cilësisë. ▪ Funksionimi i bazës të dhënave, me qëllim raportimin periodik të gjithë përfituesve të shërbimeve sociale në territorin e bashkisë së Shkodrës. ▪ Funksionimi i bazës të dhënave në nivel bashkie për të gjithë ofruesit e shërbimeve, tipologjisë së shërbimeve, kapaciteteve të tyre dhe grupeve të përfituesve. ▪ Organizim të fushatave të ndërgjegjësimit dhe komunikimi me publikun e gjerë për promovimin e shërbimit të kujdestarisë dhe kulturës së solidaritetit ndaj fëmijëve dhe familjeve në nevojë si dhe fëmijëve në kujdes rezidencial. ▪ Krijimi i programeve mbështetëse për familjet biologjike me synim parandalimin e braktisjes dhe rikthimin e fëmijëve, nga kujdesi rezidencial pranë familjeve të tyre. ▪ Mbështetje teknike dhe financiare e specialistëve të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Specialistin për De-institucionalizimin dhe Kujdesin Alternativ në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik që janë identifikuar apo referuar dhe ndjekjes së planit të ndërhyrjes. ▪ Identifikimi i familjeve të mundshme kujdestare. ▪ Krijimi i regjistrit të kujdestarisë në Bashkinë e Shkodrës për familjet kujdestare. ▪ Trajnimë mbi zbatimin e programeve të ngritjes së kapaciteteve të prindërimit pozitiv si me prindër të familjeve në situatë krize ashtu dhe me prindër të mundshëm kujdestarë. ▪ Menaxhimi i rasteve emergjente të fëmijëve në bashkëpunim me policinë, shërbimin social shtetëror, organizatave partnere etj. 		
b) Rezultatet që prisni		
<ul style="list-style-type: none"> • Punonjës socialë për vlerësimin e nevojave të grupeve në nevojë dhe në ndërtimin e planeve të ndërhyrjes, të trajnuar. • Ofrim i shërbimeve sociale cilësore për kategoritë në nevojë. • Të dhëna statistikore për përfituesit e shërbimeve sociale në territorin e Bashkisë së Shkodrës. • Hartëzimi i shërbimeve sociale. • Shërbime të përkujdesjes alternative sipas standarteve të përcaktuara në ligj. 		

<ul style="list-style-type: none"> Realizim i aktiviteteve sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese me publikun e gjerë për promovimin e shërbimit të kujdestarisë dhe kulturës së solidaritetit ndaj fëmijëve dhe familjeve në nevojë si dhe fëmijëve në kujdes rezidencial. Ulje e numrit të fëmijëve në insitucionet rezidenciale. Ulje e numrit të fëmijëve në situatë rruge. Familje të mundshme kujdestare të identifikuara. Familje kujdestare të trajnuara për të ofruar shërbimin e kujdestarisë. 						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Fëmijët pa kujdes prindëror Familjet kujdestare Familjet në vështirësi social-ekonomike Institucionet publike Organizatrat Familjet dhe fëmijët në situatë rruge			Bashkia Organizatrat Institucionet publike Komuniteti			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1						
	Shuma					
f) Periudha e zbatimit Janar - Dhjetor 2018		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i Drejtorisë së Shërbimit Social, Strehimit dhe Shëndetit Publik Save the Children Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

<p>Nr. 19</p>	<p>P10.F2.O3.A9 Bashkëpunimi me Fondacionin “Shpresë për botën” për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë.</p>	<p>Llojet e programit: P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale</p> <p>P10.F2.O3.Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtetasat në nevojë.</p>
<p>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</p>		
<p>i. Situata</p>		
<p>Shtëpia e foshnjës ofron shërbim rezidencial për foshnjët dhe fëmijët e braktisur, jetimë biologjik ose social. Gjithashtu ofron shërbim ditor për foshnjët e fëmijët në nevojë. Shërbimet e ofruara janë nga më të ndryshmet duke filluar nga trajtimi mjekësor, psikosocial për foshnjët, përkujdesje, mirërritje dhe këshillim për nënat, etj. Kapaciteti i këtij institucioni është 35 fëmijë rezidencial dhe aktualisht numri i fëmijëve që marrin shërbim në këtë institucion është 10 në shërbimin rezidencial dhe 20 të shërbimit ditor.</p> <p>Shtëpia e fëmijës Shkollore ofron shërbim rezidencial për fëmijët e moshës 6 -18 vjeç. Kategoritë e fëmijëve janë kryesisht fëmijë të braktisur, fëmijë që vijnë nga familje në vështirësi dhe pamundësi ekonomike për tu përkujdesur dhe jetimë biologjik. Fëmijët marrin shërbime të tilla siç janë: mirërritja dhe edukimi, shërbimi psikosocial, mjekësor, integrimi në komunitet, rikthim pranë familjeve biologjike, ndjekje të rasteve pas daljes nga insitucioni, veprimtari te tjera edukuese dhe argëtuese. Kapaciteti i shtëpisë së fëmijës është 70 dhe aktualisht numri i fëmijëve që marrin shërbim në këtë institucion është 28. Gjatë viti 2017 do të bashkëpunohet me Shpresë për Botën për mbështetjen dhe përmirësimin e veprimtarisë në institucionet rezidenciale për fëmijët në varësi të bashkisë shkodër dhe do të fillojë të mbështesë dhe qendrën e zhvillimit për PAN.</p> <p>Qendra e Zhvillimit është një institucion i përkujdesit shoqëror, qëllimi i të cilit është përkujdesi dhe riaftësimi fizik dhe mendor i personave me aftësi të kufizuara. Institucioni ofron kushte optimal për të gjithë personat e sistemuar në të si dhe kushtet ambientale, pajisje me mjete të përshtatshme për realizimin e rehabilitimit, trajtimit dhe integritit të personave me aftësi ndryshe që marrin shërbim në qendër.</p> <p>Për përmirësimin e shërbimeve ndaj fëmijëve dhe personave me aftësi ndryshe për krijimin e një atmosfere sa më të këndshme dhe sa më të përshtatshme për çdo grup-moshë që jeton në secilin institucion të përkujdesit rezidencial, me mbështetjen e fondacionit “Shpresë për botën”, mendohet të organizohen festimet e festave zyrtare, festimet e ditëlindjeve të secilit fëmijë dhe gjithashtu t'i plotësohen nevojat specifike të fëmijëve.</p> <p>Gjatë vit 2018 dhe në vijim do të vazhdojë bashkëpunimi me Shpresë për Botën për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për fëmijët në institucionet rezidenciale dhe përfituesit në qendrën e zhvillimit</p>		
<p>ii. Synimi i projektit</p>		
<ul style="list-style-type: none"> • Synojmë institucionalizimin e bashkëpunimit midis Bashkisë së Shkodrës dhe fondacionit “Shpresë për botën”. • Synojmë përmirësimin e kushteve për foshnjët, fëmijët dhe PAN që janë të sistemuar në institucionet e përkujdesit rezidencial. • Përmirësimin i shërbimit të përkujdesjes në institucionet rezidenciale në varësi të Bashkisë Shkodër. 		
<p>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</p>		
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Organizime për kremtimin e festave ndër vjetore në Shtëpitë e fëmijëve. ▪ Mbështetje me transport për realizimin e takimeve të fëmijëve me familjet biologjike me qëllim përmirësimin dhe forcimin e marrëdhënies prind-fëmijë. ▪ Furnizim me veshmbathje sipas nevojave të fëmijëve të Shtëpisë së Fëmijës Shkollore/ furnizim me pampers sipas nevojave që ka Shtëpia e Foshnjës, në mënyrë që të ndihmohet në përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar për mirërritjen e fëmijëve të këtyre institucioneve. ▪ Organizimi i festave të ditëlindjeve të fëmijëve në dy institucionet dhe blerja e dhuratave të ndryshme për ta. ▪ Organizimi i aktiviteteve të ndryshme me fëmijët e Institucioneve. ▪ Ndërrhyrje rikostruktuese pranë ambjenteve të Shtëpisë së Foshnjës/ Shtëpisë së fëmijës Shkollore, etj. ▪ Mbështetje për nevoja emergjente për Shtëpinë e fëmijës. ▪ Hartimi i projekteve të veçanta që mund të paraqiten nga Shtëpia e Fëmijës ose projekte që mund të paraqiten nga vetë fondacioni për Shtëpinë e fëmijës. 		
<p>b) Rezultatet që prisni</p>		
<ul style="list-style-type: none"> ○ Përmirësimi i shërbimit të përkujdesjes, mirërritjes dhe edukimit të fëmijëve të Shtëpisë së Foshnjës dhe Shtëpisë së Fëmijës Shkollor, Shkodër. ○ Integrimi social kulturor i fëmijëve duke synuar përfshirjen e tyre në aktivitete social kulturore 		
<p>c) Aktorët e mundshëm</p>	<p>d) Kontributet e mundshme në projekt</p>	
<p>Institucioni Shtëpia e Foshnjës Institucioni Shtëpia e Fëmijës Shkollor Qendra e Zhvillimit, Shkodër Bashkia Shkodër Fëmijët dhe personat me aftësi ndryshe te sistemuar në institucionet e përkujdesit</p>	<p>Fondacioni “Shpresë për botën” Bashkia e Shkodrës</p>	



Familjet e fëmijëve të sistemuar në institucione							
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1							
	Shuma						
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:					
Janar – Dhjetor 2018		Drejtoria e Shërbimit Social, Strehimit dhe Shëndetit Publik Stafi i Fondacionit					
		Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 20	P10.F2.O3.A10 Dita ndërkombëtare e romëve	Llojet e programit: P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale Funksioni: P10.F2.O3 Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Në kuadër të “8 Prill” ditës ndërkombëtare të Romëve, Bashkia Shkodër, në vitin 2017 organizoi aktivitete për ndërgjegjësimin e institucioneve publike, organizatave, donatorëve, por edhe të komunitetit rom për t'u bërë pjesë dhe për t'u përfshirë në procesin e integritimit të komunitetit rom në jetën sociale, ekonomike e kulturore që zhvillohen në territorin e Bashkisë së Shkodrës.</p> <p>Në Bashkinë Shkodër numërohen rreth 400 romë, nga të cilët 195 janë fëmijë, të cilët banojnë të organizuar në 4 kampe në lagjet periferike të Shkodrës.</p> <p>Në vitin 2017 është organizuar për herë të parë një aktivitet ndërgjegjësues në Shkollën Edith Durham me mbështetjen e UNDP, Arsis dhe Qendra rinore “Arka”, ku u lancua fillimi i projektit për ndërtimin e qendrës komunitare për komunitetin rom dhe egjiptian dhe projekti i edukimit për këtë komunitet. Në këtë aktivitet për herë të parë performoi trupa akrobatike e fëmijëve e quajtur “Cirku i ëndrrave”, trupë e cila përbëhet nga fëmijë të komunitetit rom dhe atyre të maxhorancës. Synimi i kësaj trupe, përveç edukimit dhe mësimin artistik, është integrimi i fëmijëve rom.</p> <p>Në vitin 2018 dhe në vazhdim do të zhvillohen aktivitete ndërgjegjësuëse që synojnë integrimin dhe fuqizimin e këtij komuniteti.</p> <p>Bashkia Shkodër ka ndërmarrë disa inisiativa të rëndësishme për përmirësimin e kushteve social ekonomike të këtij komunitetit, në zbatim të Planit Lokal për fëmijët në situatë ruge dhe në bashkëpunim me organizata që kanë si focus mbështetjen e këtij komuniteti.</p> <p>Kjo ditë vjen si apel për respektimin e të drejtave, si integrim dhe përmirësim të kushteve social ekonomike të këtij komuniteti në territorin e Bashkisë.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Synojmë ndërgjegjësimin e institucioneve publike dhe organizatave për mbështetjen dhe fuqizimin e komunitetit rom . Synojmë ndërgjegjësimin e strukturave publike përgjegjëse për një akses të barabartë në shërbimet publike që ofrohen në territor si në strehim, arsim, shëndetësi, formim profesional dhe punësim Synojmë ndërgjegjësimin e komunitetit rom për të kontribuar dhe bashkëpunuar dhe për t'u përfshirë në procesin e integritimit në jetën, sociale, ekonomike e kulturore 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Organizimi i aktivitetit social kulturor me pjesëmarrjen e fëmijëve të komunitetit Rom duke përfshirë fëmijët në situatë ruge, fëmijë të institucioneve rezidenciale dhe fëmijë romë të shkollave të tjera publike. Aktivitate sensibilizues dhe informuese në Qendrat Komunitare “Për Familjen”. Përfshirja e Shkollës Liria si qendër komunitare në mbështetje të këtij komuniteti Panair me punime nga komuniteti rom Performacë e trup akrobatike me fëmijë rom e mbështetur nga qendra rinore Arka. Takime me komunitet me mbështetjen e UNDP dhe ARSIS 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> Ndërgjegjësimi i komunitetit, institucioneve dhe organizatave mbi integrimin e komunitetit rom Zhvillimi i aktivitetit social – kulturor me pjesëmarrjen e komunitetit rom Integrimi i komunitetit rom në jetën sociale kulturore të qytetit 						
c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)				d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)		
Komuniteti rom dhe egjiptiane Institucionet publike OJF-të				Bashkia Institucionet publike OJF-të Bizneset private Komuniteti		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Libra dhe lodra për edukimin dhe argëtimin e fëmijëve	100			100	

	Shuma	100			100		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Libra dhe lodra për edukimin dhe argëtimin e fëmijëve	100			100		
	Shuma	100			100		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Libra dhe lodra për edukimin dhe argëtimin e fëmijëve	100			100		
	Shuma	100			100		
f) Periudha e zbatimit Mars -Prill 2018		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së shërbimeve sociale, shëndetit publik dhe strehimit Organizatat DAR Qendra ditore për fëmijët në situatë rruge Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					



Nr. 21	Projekti: P10.F2.O3.A11 Bashkëpunimi me organizatën SOS, Fshatrat e Fëmijëve	Lloji i programit; P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale Funksioni: P10.F2.O3. Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.			
Përshkrimi i shkurtër i projektit:					
i. Situata (Shpego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)					
<p>Ndër politikat vendore sociale të bashkisë së Shkodrës është mbulimi dhe shtrirja e shërbimeve në të gjithë territorin, me qëllim përmirësimin e situatës social – ekonomike të familjeve në kushte shumë të vështira. Për zbatimin e këtyre politikave, Bashkia e Shkodrës, gjatë vitit 2016 dhe 2017 ka krijuar dhe vënë në funksion qendrat komunitare “Për familjen”. Këto Qendra mbulojnë me shërbime çdo lagje të qytetit. Për vitin 2018 dhe në vazhdim, synojmë shtrirjen e shërbimit komunitar edhe në njësitë administrative ku nuk ekziston ky shërbim dhe gjithashtu synojmë konsolidimin e qendrave ekzistuese duke ofruar shërbime sa më cilësore për komunitetin, familjet dhe çdo individ në nevojë.</p> <p>Për arritjen e synimeve në ofrimin e shërbimeve, në qendrat komunitare për vitin 2018 do të bashkëpunojmë me organizatën Sos, Fshatrat e Fëmijëve, si një organizatë me eksperiencë shumë të mirë në fuqizimin e familjes në nivel kombëtar dhe vendor, gjithashtu kjo organizatë është një nga partnerët e rëndësishmë për mbështetjen në fuqizimin dhe integrimin e familjeve në vështirësi socio-ekonomike, parandalimin e institucionalizimit dhe fuqizimin e familjeve biologjike me qëllim deinstitutionalizimin e fëmijëve.</p>					
ii. Synimi i projektit					
<ul style="list-style-type: none"> • Synojmë ofrimin e shërbimeve parandaluese për fëmijët që janë në rrezik për të humbur kujdesin prindëror. • Synojmë mbështetje për fëmijët që kanë humbur kujdesin prindëror të vendosur në familje kujdestare me ose pa lidhje gjaku. • Synojmë bashkëpunimin përgjatë procesit gradual dhe sistematik të deinstitutionalizimit të institucioneve të përkujdesjes shoqërore, në territorin e bashkisë së Shkodrës. • Synojmë konsolidimin e marrëdhënieve institucionale midis Bashkisë Shkodër dhe organizatës Sos, Fshatrat e Fëmijëve për zbatimin e programit të bashkëpunimit në mbështetje të të drejtave të fëmijëve për mbijetesë, mbrojtje e zhvillim. 					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vazhdimësia e bashkëpunimit midis bashkisë së Shkodrës dhe organizatës Sos, Fshatrat e Fëmijëve me qëllim konsolidimin e marrëdhënieve institucionale dhe zbatimin e programit të bashkëpunimit. ▪ Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve për vlerësimin e nevojave të grupeve në nevojë dhe ndërtimin e planeve të ndërhyrjes. ▪ Forcimi i kapaciteteve në lidhje me kujdesin alternativ me bazë familjen. ▪ Organizim të fushatave të ndërgjegjësimit në kuadër të mbrojtjes dhe fuqizimit të familjes. ▪ Krijimi i programeve mbështetëse për familjet biologjike me synim parandalimin e braktisjes dhe rikthimin e fëmijëve, nga kujdesi rezidencial pranë familjeve të tyre. ▪ Identifikimi i familjeve në nevojë. ▪ Menaxhimi i rasteve emergjente të fëmijëve në bashkëpunim me policinë, shërbimin social shtetëror, etj. ▪ Advokimi për sigurimin e të drejtave të target grupit – fëmijët pa kujdes prindëror dhe ata në rrezik për ta humbur atë. ▪ Përgatitja e një shporte shërbimesh në dispozicion të fëmijëve dhe familjeve në rrezik institucionalizimi. ▪ Bashkëpunim në hartimin e planit të veprimit për çdo rast me fokus të veçantë në identifikimin e mbështetjes lidhur me fuqizimin e familjeve për të tejkaluar situatën e riskut. 					
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)					
<ul style="list-style-type: none"> ○ Shtrirje e mbulim i territorit me shërbime dhe gjithashtu shërbime cilësore për familjet në nevojë. ○ Ofrim i shërbimeve sociale cilësore për familjet në nevojë. ○ Shërbime të përkujdesjes alternative sipas standarteve të përcaktuara në ligj. ○ Realizim i aktiviteteve sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese me publikun e gjerë për promovimin e shërbimit të kujdestarisë dhe kulturës së solidaritetit ndaj fëmijëve dhe familjeve në nevojë si dhe fëmijëve në kujdes rezidencial. ○ Ulje e numrit të fëmijëve në insitucionet rezidenciale. ○ Ulje e numrit të fëmijëve në situatë rruge. ○ Përmirësim i kushteve të jetesës për familjet në nevojë. 					
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)			
Fëmijët pa kujdes prindëror Fëmijët në rrezik institucionalizimi Familjet në vështirësi social-ekonomike Institucionet publike Organizatat Familjet dhe fëmijët në situatë rruge		Bashkia Organizatat Institucionet publike Komuniteti			
e) Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
		Paga	Sigurime	Operative	Transferime

A.1							
	Shuma						
f) Periudha e zbatimit janar - dhjetor 2018		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së shërbimit social, strehimit dhe shëndetit publik Organizata Sos, Fshatrat e Fëmijëve Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

<p>Nr. 22</p>	<p>Projekti: P10.F2.O4.A2.</p> <p>Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian</p>	<p>Lloji i programit; P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale</p> <p>Funksioni:P10.F2.O4 Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.</p>
<p>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</p>		
<p>i. Situata (Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)</p>		
<p>Komuniteti rom dhe egjiptian, është ndër grupet më të varfra, më të marginalizuara dhe më të përjashtuara që jetojnë në të gjithë Shqipërinë, përfshi edhe në qytetin e Shkodrës.</p> <p>Romët dhe egjiptianët përballen me pengesa direkte dhe indirekte në qasjen në shërbimet sociale, shëndetësore, publike, etj. Studimet tregojnë se niveli i varfërisë të këtij komuniteti, është dy herë më i lartë sa shumica e popullsisë së vetë komunitetit. Frekuentimi i ulët i shkollës dhe braktisjes shumë herët, pa përfunduar arsimin e detyruar, janë rezultat i nivelit të ulët arsimor, dhe më konkretisht analfabetizmit dhe për pasojë edhe nivelit të ulët ekonomik të këtij komuniteti. Me qëllim përfshirjen e këtij komuniteti dhe lehtësimin e problematikave tyre, gjatë vitit 2017, bashkia e Shkodrës ka vazhduar zbatimin e aktiviteteve sipas memorandumit të mirëkuptimit me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD). Ky bashkëpunim synon ndërhyrjet e integruara në përmirësimin e kushteve të komunitetit rom dhe egjiptian dhe përfshirjen e tyre në sistemin arsimor, në punësim, etj.</p> <p>Gjatë vitit 2017 janë organizuar një sërë ndërhyrjesh dhe aktiviteteve ndër të cilat përmendim: zhvillimi i trajnimeve dhe takimeve me komunitetin mbi rëndësinë e punësimit, përfshirjes në kurse profesionale. Është arritur punësimi i 60 anëtarëve të komunitetit. Për herë të parë, janë identifikuar dhe regjistruar në sistemin arsimor parashkollor dhe shkollor të gjithë fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian, dhe tashmë po ndiqet frekuentimi dhe ecuria e fëmijëve në shkollë. Në zonën “Tophanë”, zonë ku jeton komunitet rom, janë mundësuar vizita mjekësore dhe trajtim mjekësor për fëmijët dhe gratë shtatzëna dhe gjithashtu në këtë zonë është mundësuar ngritja e një këndi lojrash për fëmijët, si një alternativë e mirë për largimin e tyre nga rruga; është realizuar regjistrimi i vendbanimit në gjendjen civile të bashkisë së Shkodrës për familjet rome të interesuara dhe është ofruar mbështetje për çdo procedurë administrative të nevojshme për këtë proces. Duhet të theksohet se të gjitha ndërhyrjet janë bërë në bashkëpunim të ngushtë Komunitet – Bashki – PNUD.</p>		
<p>ii. Synimi i projektit (me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitimi i grupit të synuar)</p>		
<ul style="list-style-type: none"> • Synojmë të promovojmë fuqizimin ekonomik dhe social të komunitetit rom dhe egjiptian nëpërmjet standartizimit të një qasje të re inovative dhe të integruar në nivelin politik dhe programim dhe të ofrojë modele të integruara të përfshirjes sociale në nivel vendor. • Synojmë të përmirësojmë aksesin në shërbime dhe respektimin e të drejtave njerëzore për komunitetin rom dhe egjiptian. • Synojmë të kontribuojmë në fuqizimin ekonomik dhe social të komunitetit rom dhe egjiptian. • Synojmë vazhdimësinë e aktiviteteve të planifikuara në memorandumin e mirëkuptimit, me qëllim fuqizimin dhe arritjen e autonomisë për këtë komunitet. • Synojmë ngritjen dhe funksionimin e një qendre komunitare pranë këtij komuniteti, me qëllim shtrirjen e shërbimeve të nevojshme sociale, edukative, mjekësore, etj. në komunitet. 		
<p>iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerri për të prodhuar rezultate)</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Krijimi i modeleve të reja dhe iniciativave për rritjen e mundësive për punësim të komunitetit rom dhe egjiptian. ▪ Krijimi i lehtësirave për bashkëpunim (horizontal, vertikal) ndërmjet institucioneve publike, organizatave, etj. ▪ Fuqizim/ngritje të kapaciteteve. ▪ Krijimin e mekanizmave mbështetëse për personat që jetojnë në kushte ekstreme varfërie. ▪ Vazhdimësia e projekteve infrastrukturore. ▪ Bashkëpunimi i ngushtë me organizatat partnere që veprojnë në territorin e bashkisë së Shkodrës për komunitetin rom dhe egjiptian. 		
<p>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)</p>		
<ul style="list-style-type: none"> ○ Integrimi i komunitetit rom dhe egjiptian ○ Fuqizimi socio-ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian. ○ Krijimi i aksesit në shërbime për komunitetin rom dhe egjiptian. ○ Përmirësimi i cilësisë së jetës për komunitetin rom dhe egjiptian. ○ Rritja e punësimit dhe zhvillimin e aftësive e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat e komunitetit rom dhe egjiptian. ○ Qendër komunitare funksionale në komunitet në shërbim të këtij komuniteti. 		
<p>c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)</p>	<p>d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)</p>	
<p>Komuniteti rom dhe egjiptian Komuniteti Bashkia Institucionet Publike</p>	<p>PNUD Bashkia Komuniteti</p>	

Organizatrat							
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1							
	Shuma						
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) Janar - Dhjetor 2018			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë shërbimeve sociale, shëndetit publik dhe strehimit Stafi i PNUD-it				
			Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				



Nr. 23	P10.F2.O4.A3 Shpërblim për jetimët me rastin e festave të fundvitit	Llojet e programit: P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale Funksioni: P10.F2.O4. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Në territorin e Bashkisë së Shkodrës ofrojnë shërbim rezidencial për fëmijë pa përkujdes prindëror 3 institucione të ndryshme të ndara sipas grupmoshave. Këto institucione ofrojnë shërbime për të rinjtë deri në moshën 18 vjeçare. Bashkia e Shkodrës në vitin 2017 ka aplikuar, fituar dhe zbatuar projektin për ristrukturimin e godinës së ish konviktit të shkollës pyjore, pranë MZHU, me qëllim strehimin dhe ofrimin e kushteve sa më të mira banimi për jetimët e dalë nga strukturat rezidenciale dhe që jetojnë në konviktet e shkollave të mesme të qytetit. Gjithashtu, në ndihmë të kësaj shtrese, çdo vit Bashkia e Shkodrës, në prag të festave të fundvitit, parashikon një ndihmë monetare, për jetimët në kushte shumë të vështira social-ekonomike. Qëllimi i kësaj ndihme është lehtësimi i situatës tyre ekonomike dhe krijimi i një atmosfere sa më të mirë festive.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Synojmë të ndikojmë në përmirësimin e kushteve të jetesës për jetimët. • Synojmë të krijojmë një atmosferë më të mirë në ditë festive por jo vetëm për këtë kategori. • Synojmë krijimin e mundësive për fuqizimin e jetimëve me qëllim arritjen e autonomisë për edukim, formim, punësim, etj. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përgatitja dhe sjellja e listës së jetimëve në situatë të vështirë social – ekonomike nga shoqata e jetimëve, dega Shkodër. ▪ Vlerësimi i situatës social – ekonomike për personat e përfshirë në listë, nga punonjësit e qendrave komunitare. ▪ Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për lëvrimin e fondit të parashikuar. ▪ Shpërndarja e fondit për secilin nga personat, në prag të festave të fundvitit. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> ○ Përmirësimi i kushteve të jetesës për jetimët që jetojnë në konvikte ose të sapo dalë nga strukturat rezidenciale. ○ Krijimi i mundësive të përshtatshme për fuqizimin social dhe ekonomik të kësaj kategorie. ○ Krijimi i atmosferës më të mirë festive për jetimët. ○ Paketa shërbimesh lehtësuese për përmirësimin e situatës së jetimëve në territorin e bashkisë së Shkodrës. 						
c) Aktorët e mundshëm (grupetqëlidhen me projektindheqëndikohen)				d) Kontributet e mundshmenëprojekt (kush do tëkontribuojëpërkëtëprojekt, financiarisht, etj.)		
Jetimët Shoqata e jetimëve Bashkia e Shkodrës Institucionet publike Organizatat				Bashkia e Shkodrës Shoqata e jetimëve Organizatat partnere Komuniteti		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	Ndihme me rastin e festave të fundvitit	400				400
Shuma		400				400
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	Ndihme me rastin e festave të fundvitit	400				400
Shuma		400				400
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale



A.1	Ndihme me rastin e festave të fundvitit	400				400	
	Shuma	400				400	
f) Periudha e zbatimit Shtator – Dhjetor 2018		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Shërbimit Social, Strehimit dhe Shëndetit Publik Drejtorja e Financës					



<p>Nr. 24</p>	<p>P10.F2.O4.A4 Shërbime mbështetëse dhe riaftësuese për integrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe në sistemin edukativ</p>	<p>Llojet e programit: P10.Strehimi dhe Shërbimet sociale Funksioni:P10.F2.Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.</p>				
<p>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</p>						
<p>i. Situata</p>						
<p>Autizmi është një sëmundje e cila karakterizohet nga çrregullime të marrëdhënieve sociale, të komunikimit dhe sjellje e lëvizje stereotipike. Autizmi është një sëmundje e cila po përhapet në mënyrë të shpejtë duke u shndërruar në një sfidë për shëndetin publik në mbarë botën për shkak të kostove shoqërore dhe ekonomike. Njohuritë për autizmin në shërbimin shëndetësor e më tepër në popullatën shqiptare janë shumë të pakta dhe nuk është e qartë se rritja e rasteve është rezultat i shtimit real të rasteve apo diagnostikimit më të mirë. Në Shqipëri shifrat janë në rritje, por nuk ka të dhëna të sakta. Specialistët e shëndetësisë bëjnë thirrje për sensibilizimin e opinionit publik për diagnostikimin e hershëm, përkrahjen ndaj fëmijëve autikë dhe integrimin e tyre në shoqëri. Aktualisht në Shkodër nuk kemi një shërbim të specializuar për trajtimin e fëmijëve me autizëm që të mundësojë mbështetjen dhe ofrimin e shërbimeve integruese në moshë sa më të hershme në shërbimet edukuese parashkollore dhe shkollore. Për këtë arsye janë vlerësuar ambientet e mundshme për përshtatjen dhe ngritjen e shërbimit integrues për Fëmijët me Autizëm e cila do të ofrojë shërbime informuese, rehabilituese me synim integrimin e tyre në kopësht dhe në shkollë si moshatarët e tyre.</p>						
<p>ii. Synimi i projektit (me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitim i grupit të synuar)</p>						
<ul style="list-style-type: none"> • Informimin dhe sensibilizimin e shoqërisë për autizmin dhe orientimi i tyre për ndihmë dhe shërbime. • Projekti synon mbështetjen e krijimit të shërbimeve të specializuar për trajtimin e integrimin e hershëm të fëmijëve autik. • Ofrimi i shërbimeve rehabilituese dhe integruese në moshë sa më të hershme me shërbimet edukuese parashkollore dhe shkollore për fëmijët me autizëm. • Informimin dhe trajnimin e personelit të çerdheve, kopshteve, shkollave dhe qendrave shëndetësore për diagnostimin e trajtimin e hershëm të fëmijëve autik. • Bashkërendimin me organizata të specializuara dhe donatorë për realizimin e adminstrimin e këtyre shërbimeve. 						
<p>iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)</p>						
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Trajnimin dhe përgatitjen profesionale të mësuesve dhe edukatoreve të sistemit të edukimit publik. ▪ Trajnimi dhe informimi i stafit të qendrave shëndetësore për njohjen dhe diagnostikimin e hershëm të fëmijëve autik. ▪ Trajnimi i stafit të Qendrave komunitare "Për Familjen" për të njohur dhe ofruar shërbime cilësore e të nevojshme për fëmijët autik e prindërit e tyre. 						
<p>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)</p>						
<ul style="list-style-type: none"> ○ Personel i trajnuar dhe i përgatitur për të ofruar shërbimet e duhura për fëmijët autik. ○ Staf i qendrave shëndetësore, i çerdheve dhe kopshteve i informuar dhe i trajnuar për të diagnostikuar sa më herët fëmijët autik. ○ Infrastruktura e ambientet e shkollës të përshtatshme për të pritur dhe integruar fëmijë me autizëm në sistemin e edukative parashkollore dhe shkollore. ○ Fëmijët autikë të mbështetur dhe integruar në sistemin edukativ. 						
<p>c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)</p>				<p>d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)</p>		
<p>Fëmijët autik dhe familjet e tyre, Personeli i kopshteve, çerdheve dhe qendrave shëndetësore. OJF, Mësues dhe edukator të sistemit edukativ publik.</p>				<p>Bashkia e Shkodrës, Ojfe donatorë të ndryshëm, Familjet e fëmijëve autik. etj</p>		
<p>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)</p>						
<p>Shpenzimet për çdo aktivitet 2018</p>		<p>Totali (mijë lekë)</p>	<p>Nga kjo:</p>			
			<p>Paga</p>	<p>Sigurime</p>	<p>Operative</p>	<p>Transferime Kapitale</p>
<p>A.1</p>						
<p>Shuma</p>						
<p>Shpenzimet për çdo aktivitet 2019</p>		<p>Totali (mijë lekë)</p>	<p>Nga kjo:</p>			
			<p>Paga</p>	<p>Sigurime</p>	<p>Operative</p>	<p>Transferime kapitale</p>
<p>f) Periudha e zbatimit Janar – Dhjetor 2018</p>		<p>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit Drejtorja e Shërbimit Social, Strehimit dhe Shëndetit Publik</p>				

--	--

Nr. 25	P10.F2.O4.A5 Plani i zhvillimit lokal për komunitetin rom dhe egjiptian	Llojet e programit: P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale Funksioni:P10.F2.O4 Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
---------------	---	---

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata (Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)

Romët dhe egjiptianët që jetojnë në territorin e bashkisë së Shkodrës, si pasojë e ndikimit të faktorëve social, kulturorë dhe ekonomikë shfaqin problematika që lidhen me zhvillimin, regjistrimin dhe aksesin në të drejta të këtij komuniteti. Në Bashkinë Shkodër, sipas identifikimit në terren, gjatë vitit 2017, aktualisht, komuniteti rom dhe egjiptian zë 0.014% të popullsisë totale të regjistruar, brenda njësisë administrative Qendër, ku janë të vendosur shumica e tyre. Të dyja komunitetet janë të përqëndruara në këtë njësi administrative ndërkohë që në të gjitha njësitë e tjera administrative nuk raportohet të ketë asnjë banor/familje (të paktën formalisht të regjistruar) që i takon këtyre komuniteteve. Në total popullsia romë llogaritet të jetë rreth 423 banorë (81 familje) dhe popullsia egjiptiane llogaritet të jetë 1189 banorë (269 familje) kundrejt totalit 204954 banorëve (62671 familje). Si pasojë e lëvizjeve migratore të shpeshta brenda dhe jashtë vendit, një sërë faktorësh si, gjendja e vështirë ekonomike, kushtet e papërshtatshme të banesave, kequshqyerja, burime të paqëndrueshme të të ardhurave dhe niveli i ulët arsimor e aksesit i ulët shëndetësor ndikojnë drejtëpërsëdrejti në mirëqenien e ulët të këtyre komuniteteve, duke rritur kështu akoma më shumë hendekun e integritimit socio-ekonomik me popullsinë shumicë.

Duke qënë një komunitet me kaq shumë problematika, bashkia e Shkodrës që nga viti 2016, në bashkëpunim me organizatat partnere ka ndërmarrë një sërë nismash për ofrimin e shërbimeve të nevojshme ndaj tyre. Një nga nismat e rëndësishme, është fillimi i punës për hartimin e Planit të Veprimit, si një instrument orientues dhe rregullator për koordinimin e ndërhyrjeve nga institucionet dhe organizatat me synim përmirësimin e kushteve të jetesës për këtë komunitet.

ii. Synimi i projektit (me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitim i grupit të synuar)

- Synojmë gjithëpërfshirjen në çdo hap të përgatitjes së dokumentit, në hartimin, miratimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit, e ku çdo masë e këtij Plani vjen si adresim i nevojave të sjella nga terreni dhe komuniteti.
- Synojmë propozimin dhe marrjen e masave konkrete për realizimin e objektivave, për përmirësimin e jetesës së romëve dhe egjiptianëve në territorin e bashkisë së Shkodrës.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)

- Konsultimi i draft Planit të Veprimit për Zvillimin e komunitetit lokal të romëve dhe egjiptianëve
- Miratimi i Planit të Veprimit në Këshillin Bashkiak
- Prezantimi i dokumentit final tek institucionet partnere, organizatat dhe komuniteti.
- Zbatimi i planit të Veprimit
- Koordinimi i ndërhyrjeve të integruara në mes të gjithë aktorëve përgjegjës.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)

- Plan Veprimi për Zvillimin e komunitetit lokal rom dhe egjiptian si dokument i rëndësishëm që përfshin politika specifike dhe masa konkrete për komunitetin rom dhe egjiptian.
- Përmirësim i cilësisë së jetesës dhe shërbimeve për komunitetin rom dhe egjiptian në bashkinë e Shkodrës.
- Ndërhyrje të koordinuara institucionale në shërbim të komunitetit rom dhe egjiptian.

c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)

Bashkia
 Institucionet vendore dhe rajonale
 Organizatat partnere të shoqërisë civile
 Komuniteti

d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)

Bashkia
 Institucionet publike
 OJF-të
 Komuniteti

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)

Shpenzimet për çdo	Totali (mijë	Nga kjo:
---------------------------	---------------	----------



aktivitet 2018		lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1							
	Shuma						
f) Periudha e zbatimit (kurfillon, kurpëfundon) janar – dhjetor 2018		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së shërbimeve sociale, shëndetit publik dhe strehimit. Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 26	P10.F2.O5.A1 Informimi dhe promovimi për një komunitet më të shëndetshëm	Llojet e programit: P10. Strehimi dhe shërbimet sociale Funksioni:P10.F2.O5. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.										
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:												
i. Situata												
<p>Shërbimi i shëndetit publik pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik gjatë vitit 2017 ka organizuar një sërë takimesh informuese me synim përmirësimin e shëndetit dhe cilësisë së jetës së komunitetit. Këto takime janë organizuar pranë qendrave komunitare "Për Familjen" dhe githashtu në shkollat 9 vjecare dhe të mesme të bashkisë së Shkodrës. Temat e referimeve kanë qenë sipas kalendarit kombëtar të shëndetit të miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik në përputhje me objektivat e OBSH. Organizimi dhe zhvillimi i këtyre aktiviteteve është realizuar në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor, si DRSH, DSR, DRFSDKSH me moton "Së bashku për shëndetin tuaj". Gjatë vitit 2017, janë organizuar 13 tema dhe 54 takime informuese e sensibilizuese me komunitetin.</p>												
ii. Synimi i projektit												
<ul style="list-style-type: none"> • Të promovojë dhe informojë komunitetin për një jetë të shëndetshme në bashkëpunim të ngushtë me qendrat komunitare "Për Familjen", qendrat shëndetësore të shërbimit parësor, shkollat, OJF, etj. • Të organizojë aktivitete periodike me tema të ndryshme me synim përmirësimin e shëndetit, cilësinë e jetës dhe parandalimin e sëmundjeve në komunitet. • Të promovojë zgjerimin e mëtejshëm të shërbimit shëndetësor parësor me qëllim mbulimin sa më të madh të popullsisë dhe territorit. • Të nxisë dhe mbështesë përqasjen multi-sektoriale në zhvillimin e shëndetit komunitar, bashkë me sektorin social, arsimor, sportiv, etj. • Të bashkëpunojë me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor për të organizuar aktivitetet e saj, si me DRSH, DSR, DRFSDKSH. 												
iii. Aktivitetet kryesore të projektit												
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të përgatisë prezantime dhe materiale promovuese për shëndetin bazuar në ditët ndërkombetare, si psh HIV/AIDS, kanceri i gjirit, diabetit, HTA, vaksinimi, mirëushqyerja, higjiena e përgjithshme, etj. ▪ Organizimi i së pakut 12 temave (nga 1 teme/muaj) dhe organizimi i aktiviteteve promovuese dhe edukuese në komunitet. ▪ Organizimi i tryezave të rumbullakta në komunitet dhe media me synim promovimin e jetës së shëndetshme. ▪ Bashkëpunimi i ngushtë me Agjensinë e Kontrollit Ushqimor (AKU), DSHP dhe Inspektoriatin shëndetësor Shtetëror për përmbushjen e rregullave higjieno-sanitare, në prodhimin e tregtimin e produkteve ushqimore. ▪ Bashkëpunimi i afërt me OJF, organizata dhe biznesin privat në projekte që synojnë përmirësimin e shëndetit komunitar dhe fuqizimin e sistemit shëndetësor në përgjithësi. 												
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfutuesve të synuar)												
<ul style="list-style-type: none"> ○ Komuniteti më i informuar dhe më aktiv në mbrojtje të shëndetit. ○ Qendrat komunitare "Për Familjen" pjesë aktive në koordinimin e aktivitete promovuese të shëndetit në bashkëpunim të afërt me qendrat shëndetësore dhe shkollat pranë komunitetit. 												
c) Aktorët e mundshëm.	d) Kontributet e mundshme në projekt											
Komunitetit, Mjek dhe infermier të shërbimit shëndetësor parësor. Mësues dhe nxënës të shkollave. Personel i Drejtorisë së Shëndetit Publik. OJF,	OJF, DSHP. DSR, DRFSDKSH Biznes provat,											
e) Shpenzimet e llogaritura												
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:										
A.1		<table border="1"> <tr> <td>Paga</td> <td>Sigurime</td> <td>Operative</td> <td>Transferime</td> <td>Kapitale</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </table>	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale					
Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale								
f) Periudha e zbatimit Janar – Dhjetor 2018	g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Specialist i Shëndetit Publik, Stafi i qendrave komunitare, Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër											

Nr. 27	P10.F2.O5.A2 "Projektimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor"	Llojet e programit: P10. Strehimi dhe shërbimet sociale Funksioni:P10.F2.O5. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik pranë Bashkisë së Shkodrës, ndër detyrat funksionale ka përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat në nevojë, ku pjesë e kësaj është vlerësimi i kushteve infrastrukturore të qendrave shëndetësore, ristrukturimi i tyre dhe planifikimi e projektimi i ndërhyrjeve, me synim që të krijohen kushtet e përshtatshme për komunitetin për marrjen e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor. Gjatë vitit 2017, Bashkia e Shkodrës ka përpiluar sistemin databaze për regjistrimin e çdo qendre shëndetsore në territorin e saj me të gjitha të dhënat specifike të tyre; nevojat, shërbimet, stafin, zonën që mbulon, problematikat, funksionaliteti i qendrave shëndetësore parësore etj. Gjithashtu gjatë vitit 2017 është realizuar ndërtimi dhe funksionimi i një qendre të re shëndetsore në qytetin e Shkodrës, në lagjen nr. 3; janë krijuar kushtet për funksionimin normal të qendrës shëndetësore të lagjes nr. 4 përmes vënies në dispozicion të hapësirave të nevojshme;						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Të vlerësojë dhe analizojë gjendjen aktuale të infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor dhe planifikojë ndërhyrjet e nevojshme. • Të vlerësojë kushtet infrastrukturore dhe funksionimin e qendrave dhe ambulancave shëndetësore të shërbimit parësor. • Të promovojë zgjerimin e mëtejshëm të shërbimit shëndetsor parësor me qëllim mbulimin sa më të gjerë të popullsisë dhe territorit. • Të vlerësojë dhe promovojë aksesin e barabartë për shërbimet shëndetësore në të gjithë segmentet apo grupet e popullatës. • Të identifikojë partnerë dhe të krijojë aleanca të qëndrueshme ndërmjet institucioneve dhe OJF-ve. • Të nxisë dhe mbështesë përqasjen multi-sektoriale në zhvillimin e shëndetit komunitar, bashkë me sektorin social, arsimor, sportiv, etj. • Të bashkëpunojë me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor për të organizuar aktivitetet e saj, si me DRSH, DSR, DRFSDKSH. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Krijimi dhe përditësimi i një baze të dhënash për qendrat shëndetsore parësore të gatshme, me të dhënat aktuale dhe nevojat për ndërhyrje. ▪ Projektimi dhe përmirësimi i kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor. ▪ Projektimi, përmirësimi i kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor dhe mirëadministrimi i infrastrukturës së ndërtuar. ▪ Vlerësimi dhe monitorimi periodik i ambienteve të qendrave shëndetësore të shërbimit shëndetësor parësor në gjithë territorin e Bashkisë së Shkodrës me synim prioritarizimin e ndërhyrjeve. ▪ Bashkëpunimi i afërt me OJF, organizata dhe biznesin privat në projekte që synojnë përmirësimin e shëndetit komunitar dhe fuqizimin e sistemit shëndetësor në përgjithësi. 						
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)						
<ul style="list-style-type: none"> ○ Database i përditësuar me infomacion mbi qendrat shëndetësore të shërbimit parësor në territorin e Bashkisë së Shkodrës. ○ Forcimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor në territorin e Bashkisë Shkodër. ○ Rritje e aksesit të barabartë për shërbimet shëndetësore për të gjithë grupet e popullatës. 						
c) Aktorët e mundshëm .				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Komuniteti, Stafi i shërbimit shëndetësor parësor. Personel i Drejtorisë së Shëndetit Publik. OJF,				OJF, DSHP. DSR, DRFSDKSH Biznes provat,		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1						
Shuma						
f) Periudha e zbatimit Janar – Dhjetor 2018		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së shërbimeve sociale, strehimit dhe shëndetit publik Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				



Nr. 28	P10.F3.O1.A1 Ngritja dhe vendosja në funksion e qendrave komunitare "Për Familjen"	Llojet e programit: P10. Strehimi dhe shërbimet sociale Funksioni: P10.F3.O1. Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata (Shpjego ne menyre te detajuar problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)						
<p>Gjatë vitit 2017 ka vazhduar funksionimi dhe konsolidimi i shërbimeve pranë Qendrave Komunitare "Për Familjen", si në lagjet e qytetit ashtu edhe në qendrat pranë Njësive Administrative. Gjithashtu gjatë këtij viti është punuar për krijimin dhe vënien në funksion të qendrave të reja në tre njësitë administrative në Shalë (Theth), Velipojë dhe Rrethina.</p> <p>Shërbimet bazë që ofrohen pranë qendrave komunitare janë: këshillim, informim, orientim, monitorim, vlerësim dhe ndjekje e rasteve në nevojë, etj. Shërbimet pranë qendrave ofrohen në bashkëpunim dhe me mbështetjen e organizatave partnere vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare, me synim ofrimin e shërbimeve sa më në përputhje me nevojat e territorit.</p> <p>Gjatë vitit 2017 secila qendër ka filluar hedhjen e rasteve dhe të dhënave për secilin rast në programin softëare (online) të përgatitur posaçërisht për arshivimin dhe raportimin e rasteve, përfutuese të shërbimeve të ofruara.</p> <p>Çdo Qendër Komunitare ka në përbërje personel specialistësh të fushës sociale të financuar nga Bashkia e Shkodrës e cila njëkohësisht financon edhe kostot operative të funksionimit të këtyre qendrave. Planifikimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për vitin 2018 është në shumën 9376 mijë lekë. Duke qenë se ka gjendje lekë të papërdorura nga viti 2017, në shumën lekë 2 000 mijë lekë, në planin e vitit 2018 do të paraqiten për diferencë në shumën lekë 7376 mijë lekë e ndarë në paga 6320 mijë lekë dhe sigurime shoqërore 1056 mijë lekë.</p>						
ii. Synimi i projektit (me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitim i grupit të synuar)						
<ul style="list-style-type: none"> • Konsolidimi i qendrave komunitare që janë ndërtuar dhe janë funksionale në Bashkinë e Shkodrës në ofrimin e shërbimeve në komunitet. • Synojmë ngritjen e funksionimit e 2 qendrave të reja në njësitë administrative; në Postribë, Ana e Malit dhe Bërdicë, dhe gjithashtu ngritjen e shërbimit lëvizës në njësitë administrative Pult dhe Shosh. • Mbulimin me shërbime komunitare në një territor sa më të gjërë të Bashkisë së Shkodrës • Vlerësim të situatës sociale e ekonomike, statistika të sakta për nevojat dhe mbi përfutuesit, dhe planifikimi i aktiviteteve në përputhje me nevojat reale. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimetqë do tëndërmerni per të prodhuar rezultate)						
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ofrimi i shërbimeve parashoqërore, që përfshijnë: (informim, këshillim, shërbime në familje, mbështetje psikologjike, psiko-sociale. tj). ▪ Shërbime Komunitare të plota dhe gjysmëditore, që përfshijnë: (shërbimet ndërmjetëse lidhur me punësimin, asistencë sociale dhe aspektet ligjore). ▪ Shërbime të mirëmbajtjes dhe pajisjes së ambienteve në të cilat do të krijohen dhe do të funksionojnë qendrat komunitare. ▪ Takime informim dhe promovuese për shëndetin, në bashkëpunim të ngushtë me shkollat, qendra shëndetësore dhe OJF aktive në territor. ▪ Hedhja dhe raportimi i rasteve, përfutuese të shërbimeve në sistemin online. 						
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfutuesve të synuar)						
<ul style="list-style-type: none"> ○ Qendrat komunitare te gatshme nga ana infrastrukturale dhe funksionale duke ofruar shërbime sociale. ○ 3 Qendra Komunitare të reja të ngritura dhe operative në njësitë administrative Postribë, Ana e Malit dhe Bërdicë. ○ Shërbimi lëvizës funksional dhe në mbulim të njësive administrative malore. 						
c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)				d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)		
Komunitetit, (OJF-organizatat jofitimprurëse), Institucionet rajonale të shërbimit social, shëndetësisë, arsimit, etj.				OJF, DAR-DrejtoriaArsimoreRajonale, DSHP-Drejtoria e ShëndetitPublik, DVP-DrejtoriaVendore e Policisë. Biznes privat,		
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Punonjës menxhimi i qendres komunitare (16 ne total).	7 376	6 320	1 056		
A.2	Energji elektrike	950			950	
A.3	Uje	400			400	
A.4	Mirembajtje	1 134			1 134	



A.5	Desktop+printer	300					300
A.6	Paisje zyre	370					370
A7	Shpenzime transporti	1 000			1 000		
	Shuma	11 530	6 320	1 056	3 484		670
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Punonjës menxhimi i qendres komunitare (17 ne total).	8 893	7 620	1 273			
A.2	Energji	700			700		
A.3	Uje	400			400		
A.4	Mirembajtje	80			80		
A.5	Desktop+printer	300					300
A.6	Paisje zyre	390					390
	Shuma	10 763	7 620	1 273	1 180		690
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Punonjës menxhimi i qendres komunitare (17 ne total).	9 262	7 936	1 326			
A.2	Energji	700			700		
A.3	Uje	400			400		
A.4	Mirembajtje	363			363		
A.5	Desktop+printer						
A.6	Paisje zyre	400					400
	Shuma	11 125	7 936	1 326	1 463		400
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) Janar – Dhjetor 2018		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Sherbimit Social, Strehimit dhe Shendetit Publik. Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 29	Projekti:P10.F3.O1.A2 Administrimi dhe funksionimi i Çerdheve	Llojet e programit: P10. Strehimi dhe Shërbimet sociale Funksioni:P10.F3.O1. Ndërtimi dhe administrimi i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale.
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Drejtorja e Kopshteve dhe Çerdheve administron kopshtet dhe çerdhet në territorin e bashkisë së Shkodrës. Aktualisht kjo drejtori menaxhon shërbimet dhe mbështetjen me paga për personelin për 57 kopshte. 22 kopshte të licënuara dhe 1 në proces licënsimi në qytetin e Shkodrës, 6 kopshte me ushqim, 35 në njësitë administrative dhe 3 çerdhe. Referuar vitit 2017, numri i fëmijëve që përfitojnë nga ky shërbim është rreth 2118 fëmijë në kopshte (1023 femra), dhe rreth 155 në çerdhe (75 femra).</p> <p>Administrata e drejtorisë përbëhet nga 5 punonjës dhe 2 punonjës shërbimi. Shërbimi në kopshte kryhet me 128 edukatore, dhe 35 personel shërbimi mbështetës (kuzhinierë, ndihmës kuzhinierë, sanitare, roje). Shërbimi në çerdhe kryhet me 31 kujdestare dhe 20 personel shërbimi (kuzhinierë, ndihmës kuzhinierë, sanitare, roje).</p> <p>Drejtorja e kopshteve dhe Çerdheve administron 3 çerdhe:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Çerdhe "1 Qershori" që i shërben lagjes nr. 1, dhe lagjes nr.2: me sipërfaqe ndërtese 153 m², me kapacitet për 60 fëmijë, numri mesatar i frekuentimit të fëmijëve është 58. Numri i personelit që shërben është 19. 2. Çerdhe "Perash" që i shërben lagjes nr.1, me sipërfaqe ndërtese 558 m², me një kapacitet (nr vendesh) prej 60 fëmijë dhe numri mesatar i frekuentimit është 60 fëmijë. Numri i personelit që shërben është 18. 3. Çerdhe "Manush Alimani", vendodhja Bahçja e Çakajve, që i shërben lagjes nr. 2, me sipërfaqe 143 m², me një kapacitet prej 40 fëmijë dhe numër mesatar i frekuentimit shkon deri 35 fëmijë. Numri i personelit që shërben është 14. <p>Llogaritja e pagave për vitin 2018 është bërë mbi bazën e vendimit nr. 205 dt.19.06.2017 "Për miratimin e Strukturës së Administratës dhe të Institucioneve të Varësisë të Bashkisë Shkodër, për vitin 2017" dhe në bazë të Vendimit të K.M nr 175, date 8.3.2017".) Kështu shërbimi i administrimit nga ana e drejtorisë dhe pagesat e punonjësve të shërbimit në çerdhe mbulohen me 26186 mijë lekë për paga dhe sigurime shoqërore me burim financimi nga transfertat e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta.</p> <p>Për administrimin dhe funksionimin e çerdheve kërkohet mbështetja për personelin që shërben dhe materialet e domosdoshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Furnizime me ushqime, me fond 4300 mijë lekë për rreth 155 fëmijë; • Materiale për pastrim dhe shërbime për ambientet; rreth 820 mijë lekë • Shërbim i energjisë elektrike, • Shërbim me ujë të pijshëm • Shërbim i ngrohjes dhe gatimit; • Shërbime të tjera për dizinfektim; • Mirëmbajtjen e zakonshme të ndërtesave; • Mirëmbajtjen e pajisjeve teknike; • Sigurimin e ndërtesave; <p>Furnizimi me ushqime do të bëhet për 3 çerdhe. Për ushqyerjen e këtyre fëmijëve përgatitet menyuja ditore sipas normativave të caktuara. Duke bazuar tek menyuja hartohet situacioni dhe sipas ditë ngrëniesve del edhe kuota ditore. Kjo kuota është llogaritur 120 lekë në ditë.</p> <p>Për krijimin e kushteve sa më të favorshme për qëndrimin e fëmijëve është e domosdoshme blerja e materialeve si: (enë kuzhine, batanije etj.)</p> <p>Është bërë planifikimi për energjinë elektrike në bazë të kw të konsumuar në çerdhe.</p> <p>Është bërë një planifikim për konsumin e ujit për çerdhet.</p> <p>Është planifikuar ngrohja me dru dhe kaldajë me naftë për çerdhe.</p> <p>Është bërë planifikimi për mirëmbajtjen e zakonshme të ndërtesave si: bojatisje çerdheve si dhe riparime të ndryshme të hidroliqeve. Po kështu janë llogaritur shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve e pajisjeve teknike. Për të zëvendësuar pajisjet e amortizuara është e domosdoshme blerja e pajisjeve të reja për çerdhet si: 2 shporetë për ngrohje, 1 frigorifer, 1 lavatrice dhe 1 shporet profesional me gaz për gatim. Po kështu është planifikuar blerja e 1 kompjuteri për zyrën e administrimit në drejtori.</p> <p>Bashkia Shkodër parashikon rikonstruksionin e plotë të godinës në të cilën, një pjesë të saj funksionon kopshti "Guerrile". Në këtë godinë parashikojmë të ndërhyjmë për rikonstruksionin e hapësirave që nuk përdoren për zgjerim të hapësirës për fëmijët e kopshteve dhe krijimin e një hapësire për funksionimin e një çerdheje.</p> <p>Njëkohësisht po vlerësojmë përdorimin e hapësirës në dispozicion për krijimin e e çerdheve të reja.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<p>Ofrimi i shërbimit në çerdhet për fëmijët e familjeve në Shkodër.</p> <p>Vlerësim i nevojave aktuale për shtimin e shërbimit për fëmijët në çerdhe.</p> <p>Përmirësim i shërbimit në çerdhe për fëmijët e familjeve në Shkodër.</p> <p>Përmirësimin e cilësisë së ushqimit dhe kujdesit ndaj fëmijëve.</p>		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		

<ul style="list-style-type: none"> ▪ Procedurat për verifikimin e nevojave për shërbim në çerdhe; ▪ Përgatitja e specifikimeve teknike për mallra dhe shërbime; ▪ Realizimi i procedurave të prokurimit; ▪ Realizimi i aktiviteteve, shërbimeve dhe mbështetjes së personelit, sipas planifikimit; ▪ Monitorim dhe raportim i aktivitetit mujor për realizimin e projektit; 						
b) Rezultatet që prisni						
Realizimin e të gjitha shërbimeve për krijimin e kushteve të përshtatshme në të gjitha çerdhet. Rritjen e numrit të fëmijëve që frekuentojnë çerdhet.						
Fëmijët në të gjitha çerdhet në Bashkinë e Shkodrës të kenë kushte sa më të favorshme për qëndrimin e tyre.						
c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)				d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)		
Fëmijët që frekuentojnë çerdhet në Bashkinë e Shkodrës Familjet e fëmijëve që frekuentojnë çerdhet Komuniteti				Bashkia Shkoder Drejtoria e Kopshteve dhe e Cerdheve		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.3.1	Shpenzime për paga dhe sigurime të punonjësve	26 186	22 592	3 594		
A.3.2	Kancelari	85			85	
A.3.3	Materiale për pastrim, dizinfektim ngrohje dhe ndriçim	1 000			1 000	
A.3.4	Furnizime me ushqime	4 300			4 300	
A.3.5	Materiale të tjera	260			260	
A.3.6	Energji elektrike	820			820	
A.3.7	Uji	980			980	
A.3.8	Internet	36			36	
A.3.9	Lëndë djegëse (dru zjarri)	300			300	
A.3.10	Shërbime të tjera për dizinfektim	40			40	
A.3.11	Shpenzime transporti	200			200	
A.3.12	Mirëmbajtje e zakonshme (ndërtesa)	400			400	
A.3.13	Mirëmbajtje e aparateve e paisjeve teknike	50			50	
A.3.14	Mirëmbajtje të paisjeve të zyrës	30			30	
	Shpenzime për sigurimin e ndërtesave	40			40	
A.3.16	Transferta buxhetore për individë	84				84
A.3.17	Blerje paisje dhe orendi	240				240
A.3.18	Blerje paisje për sistemin e sigurimit	100				100
A.3.19	Blerje paisje zyre	60				60
	Shuma	35 211	22 592	3 594	8 541	84 400
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.3.1	Shpenzime për paga dhe sigurime të punonjësve	26 720	23051	3669		
A.3.2	Materiale e shërbime zyre të përgjithshme	1 115			1 115	
A.3.3	Furnizime me ushqime	4 300			4 300	



A.3.4	Materiale të tjera	300			300		
A.3.5	Energji elektrike	750			750		
A.3.6	Uji	980			980		
A.3.7	Internet	36			36		
A.3.8	Lëndë djegëse(dru zjarri)	400			400		
A.3.9	Shpenzime transporti	180			180		
A.3.10	Mirëmbajtje e zakonshme (ndërtesa)	400			400		
A.3.11	Mirëmbajtje e aparateve dhe pajisjeve teknike	50			50		
A.3.12	Mirëmbajtje të paisjeve të zyrës	30			30		
A.3.13	Transferta buxhetore për individë	84				84	
A.3.14	Blerje paisje dhe orendi	350					350
	Shuma	35 695	23 051	3 669	8 541	84	350
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.3.1	Shpenzime për paga dhe sigurime të punonjësve	27 254	23 514	3 740			
A.3.2	Materiale e shërbime zyre të përgjithshme	1 115			1 115		
A.3.3	Furnizime me ushqime	4 300			4 300		
A.3.4	Materiale të tjera	300			300		
A.3.5	Energji elektrike	750			750		
A.3.6	Uji	980			980		
A.3.7	Internet	36			36		
A.3.8	Lëndë djegëse(dru zjarri)	400			400		
A.3.9	Shpenzime transporti	180			180		
A.3.10	Mirëmbajtje e zakonshme (ndërtesa)	400			400		
A.3.11	Mirëmbajtje e aparateve e paisjeve teknike	50			50		
A.3.12	Mirëmbajtje të paisjeve të zyrës	30			30		
A.3.13	Transferta buxhetore për individë	84				84	
A.3.13	Blerje paisje dhe orendi	350					350
	Shuma	36 229	23 514	3 740	8 541	84	350
f) Periudha e zbatimit Janar – Dhjetor 2018			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Kopshteve dhe Çerdheve Stafi i drejtorisë së shërbimeve sociale, strehimit dhe shëndetit publik Institucioni likuidues: Drejtorja e Kopshteve dhe Çerdheve				

Nr. 30	P10.F3.O1. A3. Shërbime alternative për fëmijët dhe familjen.	Llojet e programit: P 10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale Funksioni: P10.F3.O3. Ndërtimi dhe administrimi i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale.					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i. Situata (Shpjego ne menyre te detajuar problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)							
<p>Mbështetja dhe promovimi i të drejtave të fëmijëve për mbijetesë, mbrojtje e zhvillim; si dhe të drejtën për të jetuar e rritur në një ambient familjar, qoftë ky familja biologjike apo familje alternative është një nga prioritetet qe Bashkia Shkodër ka ndërmarrë duke bashkëpunuar edhe me organizata jo qeveritare që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.</p> <p>Në zbatim të VKM 89 datë 26. 01 2012 në Bashkinë Shkodër është i ngritur dhe funksionon komisioni multidisiplinar i kujdestarisë, i cili shqyrton kërkesat e familjeve kujdestare dhe vendos caktimin e fëmijës pa kujdes prindëror në familje kujdestare. Qëllimi i këtij shërbimi është zgjerimi i formave alternative në strukturat rezidenciale për fëmijët drejt deinsitucionalizimit të shërbimeve të përkujdesjes. Sistemimi i fëmijëve në familjen kujdestare organizohet dhe mbikqyret nga Bashkia nëpërmjet komisionit multidisiplinar të kujdestarisë.</p> <p>Sigurimi i mbrojtjes shoqërore për fëmijët pa kujdes prindëror dhe i të drejtave të tyre janë sfida për Bashkinë e Shkodrës, por edhe për shoqërinë civile, duke kërkuar një vëmendje më të veçantë për këtë target grup. Gjithashtu dhe numri në rritje i fëmijëve që punojnë ose lypin, i fëmijëve që janë braktisur ose janë lënë përkohësisht nën kujdesin e të afërmeve, nevojitet të trajtohet si një problem serioz si nga Bashkia ashtu dhe shoqëria civile.</p>							
ii. Synimi i projektit (me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitimi i grupit të synuar)							
<ul style="list-style-type: none"> • Ofrimi i shërbimeve parandaluese në mbështetje të familjeve në vështirësi. • Deinsitucionalizimi nëpërmjet fuqizimit të familjes që kanë fëmijët në institucionet e përkujdesit rezidencial. • Synojmë krijimin e mundësive dhe zbatimin e të drejtës themelore të fëmijëve për të jetuar e rritur në një ambient të përshtatshëm familjar, qoftë kjo familja biologjike apo familja kujdestare. • Parandalimi i institucionalizimit të fëmijëve. • Promovimi i kujdestarisë familjare si një alternative në rastet e fëmijëve dhe familjeve në vështirësi. 							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)							
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fuqizimin e strukturave të shërbimeve sociale në menaxhimin e gjithë procesit të kujdestarisë që nga identifikimi, selektimi, trajnimi i familjeve kujdestare, ndjekja e vendosjes së fëmijës në kujdestari dhe përshtatja me familjen kujdestare. ▪ Krijimin e një grupi ekspertesh që do trajnojnë në vijim gjithë punonjësit socialë të përfshirë në këtë iniciativë ▪ Ndërhyrje në fuqizimin e familjeve me qëllim parandalimin apo re-integrimin e fëmijëve nga kujdesi rezidencial ▪ Advokim për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe procedurial për shërbimin e kujdestarisë ▪ Fushata sensibilizimi ▪ Përgatitje të fletëpalosjeve për ndërgjegjësime dhe informim të komunitetit 							
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)							
<ul style="list-style-type: none"> ○ Ngritje e kapaciteteve në ofrimin e shërbimit të kujdestarisë, parandalimit dhe integrimit. ○ Rritje e numrit të familjeve të mundshme kujdestare ○ Përmirësimi i situatës ekonomike e sociale për familjet dhe fëmijët në rrezik ○ Fuqizim i familjeve biologjike të fëmijëve të institucionalizuar. 							
c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe qëndrojnë)			d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë përkëtë projekt, financiarisht, etj.)				
Fëmijët pa kujdes prindëror Familjet kujdestare Familjet në vështirësi social-ekonomike Institucionet publike Organizatat Familjet dhe fëmijët në situatë rruge			Bashkia Organizatata Institucionet publike Komuniteti				
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Materiale promovionale	100			100		
Shuma		100			100		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale



					e	
A.1	Materiale promocionale	100			100	
	Shuma	100			100	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Materiale promocionale	100			100	
	Shuma	100			100	
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) Janar – Dhjetor 2018		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së shërbimit social, strehimit dhe shëndetit publik Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

<p>Nr. 31</p>	<p>Projekti: P10.F3.O1.A4.</p> <p>Ndërhyrje të integruara për përfshirjen dhe integrimin socio-ekonomik të fëmijëve dhe të rinjve.</p>	<p>Lloji i programit; P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale</p> <p>Funksioni:P10.F3.O1. Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale.</p>
<p>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</p>		
<p>i. Situata (Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)</p>		
<p>Në territorin e Bashkisë së Shkodrës, ofrojnë shërbime të përkujdesit rezidencial për fëmijët jetim biologjik dhe social 3 institucione të ndarë përkatësisht sipas grupmoshave 0 – 3 vjeç, 3 – 6 vjeç dhe 6 – 18 vjeç. Në kuadër të reformave në legjislacionin mbi shërbimet sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve, institucionalizimi tashmë nuk është zgjidhja më e mirë për fëmijët pa përkujdes prindëror, pasi nuk përmbush kërkesat themelore për rritje, edukim dhe zhvillim të shëndetshëm. Gjithashtu fëmijët dhe të rinjtë të cilët pasi kanë mbushur moshën, kanë dalë nga strukturat rezidenciale, kanë shumë vështirësi në integrimin e tyre në jetën socio ekonomike; kanë braktisur shkollën, nuk kanë marrëdhënie të qëndrueshme në punë e për pasojë janë në situatë të vështirë socio-ekonomike dhe vulnerabël ndaj fenomeneve sociale si trafikimi, abuzimi, varësia nga substancat narkotike, etj.</p> <p>Me synim ofrimin e kushteve sa më të përshtatshme për mirëritjen dhe zhvillimin e fëmijëve, Bashkia e Shkodrës po implementon shërbimet alternative të kujdestarisë për fëmijët pa përkujdes prindëror; shërbimin e kujdestarisë familjare me lidhje gjaku, shërbimin e kujdestarisë familjare pa lidhje gjaku dhe ofrimin e shërbimeve në shtëpi – familje.</p> <p>Ndërsa me synim parandalimin e institucionalizimit, po koordinohen shërbimet në territor për fuqizimin e familjeve në vështirësi socio-ekonomike.</p> <p>Përveç kësaj, për të rinjtë të cilët tashmë kanë dalë nga strukturat rezidenciale, po planifikohen shërbime për mbështetjen e fuqizimin e tyre përmes përfshirjes në kurse profesionale me synim arritjen e autonomisë për kujdesin personal social, ekonomik, etj.</p>		
<p>ii. Synimi i projektit (me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitimi i grupit të synuar)</p>		
<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve për fëmijët që jetojnë në institucionet e përkujdesit rezidencial, nëpërmjet ofrimit të kurseve të trajnimit për stafin psiko-social të institucioneve. • Përmirësimi i kushteve të jetesës së fëmijëve pa përkujdes prindëror, nëpërmjet ofrimit të shërbimit të shtëpi-familjeve. • Fuqizimi socio-ekonomik dhe integruar për të rinjtë që kanë dalë nga strukturat rezidenciale. 		
<p>iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerri për të prodhuar rezultate)</p>		
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi, ofrimi dhe certifikimi i moduleve të trajnimit kurrikular për përmirësimin dhe specializimin e aftësive profesionale të stafit psiko-social të institucioneve të përkujdesit rezidencial në territorin e bashkisë së Shkodrës dhe të punonjësve social në bashkinë e Shkodrës. ▪ Zhvillimi i moduleve të trajnimit për stafin psiko-social. ▪ Identifikimi i të rinjve jetimë, që jetojnë në territorin e bashkisë së Shkodrës dhe vlerësimi i situatës së tyre. ▪ Koordinimi i shërbimeve të ngjashme që ofrohen në territor me synim shmangien e mbivendosjes së shërbimeve dhe ofrimin e shërbimeve sa më afër nevojave të target grupit: jetimë. ▪ Ndërtimi dhe funksionimi i një shtëpi-familje për fëmijët pa përkujdes prindëror të bashkisë së Shkodrës që aktualisht jetojnë në jetimore. ▪ Organizimi i kurseve të riaftësimit shkollor, edukimit të autonomisë dhe bashkëjetesës për jetimët që jetojnë në Banesa Sociale dhe në strukturat rezidenciale të Bashkisë së Shkodrës. 		
<p>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)</p>		
<ul style="list-style-type: none"> ○ Ngritja e kapaciteteve të specialistëve që ofrojnë shërbime në insitucionet e përkujdesit rezidencial dhe jo vetëm. ○ Përmirësimi i kushteve dhe cilësisë së jetesës për fëmijët e bashkisë së Shkodrës që jetojnë në institucione rezidenciale dhe pa përkujdes prindëror. ○ Shtëpi – familje e gatshme për fëmijët pa përkujdes prindëror, si një shërbim alternativ në kuadër të deinstitutionalizimit të fëmijëve që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe parandalimit të institutionalizimit për fëmijët e familjeve në vështirësi socio-ekonomike. ○ Të rinj jetimë, pa përkujdes prindëror e familjar, të fuqizuar dhe autonom. 		
<p>c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)</p>	<p>d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)</p>	
<p>Komuniteti Bashkia Organizatrat Institucionet rezidenciale</p>	<p>Komuniteti Bashkia Organizatrat Partnere Institucionet rezidenciale Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Shkencave të Edukimit</p>	

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1						
	Shuma					
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1						
	Shuma					
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1						
	Shuma					
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) janar - dhjetor 2018			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së shërbimit social dhe strehimit Institucioni likuidues: MAE			



Nr. 32	P10.F3.O2.A1 Qendra Rinore "Po të Ardhmes"	Llojet e programit: P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale Funksioni: P10.F3.O2 Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale.	
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:			
i. Situata			
<p>Mungesa e institucioneve publike në shërbim të rinjve në Bashkinë e Shkodrës solli si domosdosshmëri fillimin e punës për përgatitjen e një projekti me shërbimet e nevojshme për objektin e hapësirën e duhur.</p> <p>Kjo situatë solli që Bashkia e Shkodrës të vendoste në objektivat e saja ndërtimin dhe vënien në funksion të një qendre rinore publike, dedikuar promovimit të përfshirjes artistike, kulturore dhe sociale të rinjve. Të rinjtë janë një forcë pozitive për ndryshim, ndaj dhe zhvillimi i strategjive dhe investimeve do të synojë zhvillimin e tyre. Për më tepër, zhvillimi rinor është një nga prioritetet e Bashkisë së Shkodrës, kështu që krijimi i një strukture publike në mbështetje të rinisë është pika kyçe në krijimin e një sistemi mbështetës për ta.</p> <p>Objektivi i përgjithshëm dhe fokusi afatgjatë i projektit "PO të ardhmes" është të promovojë përfshirjen sociale të rinjve dhe mbështetjen e pjesëmarrjes së tyre aktive në zhvillimin social të Bashkisë së Shkodrës duke ju lehtësuar aksesin në shërbime të tilla si edukimi formal dhe joformal, sipërmarrja, kultura, informacioni dhe ICT, pavarësisht nga seksi, raca, etnia, kultura, besimi, paaftësia, mosha dhe orientimi seksual</p>			
ii. Synimi i projektit (me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitim i grupit të synuar)			
<ul style="list-style-type: none"> • Përfshirja dhe fuqizimi i të rinjve, duke stimuluar kapacitetin dhe shprehitë e tyre krijuese, inovative dhe sipërmarrëse. • Përmirësimi i aksesit në informacion për të rinjtë për punësimin, kulturën, edukimin formal dhe joformal, duke konsideruar në mënyrë të veçantë të rinjtë me aftësi ndryshe. • Inkurajimi i dialogut rinor, përmirësimi i njohurive në qytetarinë aktive, rritja e kapaciteteve të organizatave rinore dhe forcimi i vullnetarizmit. • Funksionimi, konsolidimi i shërbimeve si: informim, edukim dhe trajnime profesionale pranë qendrës rinore publike. 			
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)			
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rikonstruksioni dhe arredimi i hapësirës së identifikuar ▪ Krijimi i hapësirave publike për aktivitetet rinore ▪ Programimi dhe organizimi i aktiviteteve rinore në Qendrën Rinore. ▪ Përgatitja e Planit të Komunikimit dhe identiteti vizual i Qendrës Rinore, materialet promocionale dhe gazeta rinore. ▪ Krijimi i Qendrës së Informacionit për Rininë në Bashkinë e Shkodrës. ▪ Hapja e sportelit pranë Bashkisë së Shkodrës. ▪ Organizimi i aspekteve komunikuese (broshura, fletëpalosje, website, database) ▪ Stimulimi i dialogut mes të rinjve dhe autoriteteve publike, inkurajimi i qytetarisë aktive, rritje e kapaciteteve të OJF-ve rinore dhe inkurajim i vullnetarizmit. ▪ Organizim i kursit social-politik duke përfshirë të rinj dhe autoritete publike. ▪ Organizim i 4 takimeve mes të rinjve dhe departamenteve të ndryshme të Bashkisë së Shkodrës ose institucioneve lokale. ▪ Organizim i kursit "Cikli i menaxhimit të projekteve" për aktorët rinore (OJF rinore dhe të rinj aktivë) ▪ Krijimi i rrjetit të OJF-ve, mbështetës për rininë dhe organizmimi i takimeve periodike. ▪ Organizim i 5 fushatave promocionale për inkurajimin e vullnetarizmit në fakultete të ndryshme të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi". ▪ Organizim i 4 takimeve me vullnetarë – promovimi i praktikës më të mirë të realizuar. ▪ Organizimi i Panairit të Parë në Bashkinë e Shkodrës- Dita e Vullnetarizmit, Menaxhimi i Projektit ▪ Organizimi i takimeve periodike të asamblesë së partneritetit. ▪ Organizimi i konferencës së hapjes dhe mbylljes së projektit. 			
b) Rezultatet që prisni			
<ul style="list-style-type: none"> ○ Rritje mundësish për përfshirje sociale dhe fuqizim të rinjve ○ Stimulim i krijimtarisë artistike, ideve inovative dhe aftësive sipërmarrëse tek të rinjtë. ○ Rikonstruksioni dhe arredimi i Qendrës së Parë Rinore Publike. ○ Krijim dhe lehtësim të aksesit në informacion të rinjve, me kujdes të veçantë për të rinjtë me aftësi ndryshe. ○ Hapja e shërbimit të informimit për rininë pranë Bashkisë së Shkodrës dhe Qendrës Rinore. ○ Stimulimi i dialogut mes të rinjve dhe autoriteteve publike dhe inkurajimi i qytetarisë aktive. ○ Rritje kapacitetesh të OJF-ve Rinore. ○ Inkurajimi i vullnetarizmit tek të rinjtë 			
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt	
Të rinjtë e Bashkisë Shkodër Komuniteti		IADSA Bashkia Shkodër	



Universiteti i Shkodrës OJF			IPSIA - Itali Bashkia e Triestes – Itali Consulting and Development Partners - Shqipëri				
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A1	Paga dhe sigurime shoqërore e shëndetsore	562	482	80			
A2	Shpenzime Operative	80			80		
A3	Investime	1 156					1 156
A4	Transferime	2 308				2 308	
	Shuma	4 106	482	80	80	2 308	1 156
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A1	Shpenzime Operative	80			80		
	Shuma	80			80		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A1	Shpenzime Operative	80			80		
	Shuma	80			80		
f) Periudha e zbatimit (kurfillon, kurpërfundon) janar – dhjetor 2018			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së shërbimeve sociale, shëndetit publik dhe strehimit. Stafi IADSA Institucioni likuidues: IADSA				

Nr. 33	P10.F4.O1.A1 Projekti "Shpresa" për personat e braktisur dhe me aftësi ndryshe	Llojet e programit: P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale Funksioni:P10.F4.O1 Në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për Mirëqenien Sociale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Projekti Shpresa, është një organizatë e licënsuar që ofron shërbim të përkujdesit social të tipit shtëpi-familje, për PAN-të e braktisur nga familja dhe të deinstitutionalizuar. Kjo organizatë, është krijuar dhe vepron në qytetin e Shkodrës që prej vitit 1995. Projekti "Shpresa" ka 6 shtëpi-familje, të shpërndara në komunitet dhe aktualisht marrin shërbim 58 persona me aftësi ndryshe.</p> <p>Projekti "Shpresa", duke ofruar shërbime alternative për personat me aftësi ndryshe, të cilët janë pa asnjë përkujdes dhe interesim familjar, dhe me problematika të ndryshme, ka nevojë për mbështetje financiare dhe vëmendje të shtetit. Mbështetja e projektit "Shpresa" është një domosdoshmëri, për të ofruar shërbimin sipas standarteve të përcaktuara në ligj për personat me aftësi ndryshe dhe përmbushjen e nevojave sipas rasteve specifike.</p> <p>Në vitin 2017, bashkia Shkodër, projektit "Shpresa", i ka mbuluar përveç fondit për paga dhe sigurime shoqërore për 24 punonjës të personelit, gjithashtu ka mbuluar dhe pagat për administratorin e shtëpi familjes, si dhe psikologun klinik dhe infermierin.</p> <p>Përveç pagesës për personelin, Bashkia Shkodër ka mbështetur Projektin "Shpresa" duke mbuluar, kuotën ushqimore për personat me aftësi ndryshe të sistemuar pranë kësaj shtëpi Famije dhe energjinë elektrike sipas marrvëshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Shkodër dhe Projektit Shpresa me datë 4.5.2016 dhe Nr. 5087 Prot.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Synojmë ofrimin e shërbimeve alternative për PAN-të, si shërbimin e deinstitutionalizimit dhe parandalimin e institucionalizimit për PAN-të në rrezik, në shtëpi – familjet e projektit "Shpresa" sipas standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për persone. • Synojmë t'i japim siguri dhe jetëgjatësi shërbimeve alternative pranë projektit "Shpresa" për PAN-të e braktisur dhe pa përkujdes familjar dhe në vështirësi ekonomiko-sociale. 		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kërkesa nga projekti "Shpresa" për mbështetje me fond për vitin 2018. ▪ Parashikimi i fondit për projektin "Shpresa" në buxhetin e shtetit për vitin 2018, nga ministria e linjës. ▪ Nënshkrimi i marrëveshjes midis bashkisë Shkodër dhe projektit "Shpresa" për fondin e parashikuar dhe lëvrimin e tij për vitin 2018. ▪ Përgatitja e dokumentacionit nga projekti "Shpresa" dhe sjellja e dokumentacionit pranë zyrës së shërbimit social, çdo fillim muaji. Pagat e punonjësve të projektit "Shpresa" janë të llogaritura sipas Vendimit nr. 690, datë 09.10.2012 "për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.77, datë 23.06.2009 të Këshillit të Ministrave "për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", të ndryshuar". Gjithashtu kuota ushqimore e parashikuar për personat që jetojnë në këto shtëpi-familje të projektit "Shpresa", është e llogaritur sipas Udhëzimit nr. 5, datë 01.08.2012 "Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror". Aktualisht në shtëpitë-familje të projektit "Shpresa" jetojnë 58 persona me aftësi ndryshe, nga të cilët 33 prej tyre përfitojnë pensionet e invaliditetit, për të cilët nuk kërkohet kuotë ushqimore nga organizata. 25 persona janë pa pensione invaliditeti për shkak të problematikave dhe mungesave të dokumentacionit. Ne baze të udhëzimit Nr.5 datë 1.8.2012, "Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime", duke u mbështetur në pikën 4 të nenit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë në zbatim të nenit 24 të ligjit 9355, datë 10.3.2005, konkretisht pika d ku përcakton: kuota ushqimore për personat e vendosur në qendrat e zhvillimit është 340 lekë në ditë. (365 ditë x 25 persona x 340 leke/ditë = 3102500 leke/vit) ▪ Përgatitja e relacionit dhe shkresës përcjellëse për lëvrimin e fondit, për Drejtorinë e Financës. ▪ Monitorimi dhe vlerësimi i ofrimit të shërbimeve në projektin "Shpresa". 		
b) Rezultatet që prisni		
<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i shërbimit të ofruar për PAN-të që jetojnë në shtëpi-familjet e projektit "Shpresa". • Parandalimi i institucionalizimit të personave me AN. • Mbështetje afatgjatë e sigurtë për klientët që jetojnë në shtëpi – familjet e projektit "Shpresa". • Bashkëpunim i ngushtë me organizatën projekti "Shpresa". • Përmirësim i situatës së PAN-ve të qytetit të Shkodrës, që janë të braktisur nga familja, duke i sistemuar në projektin "Shpresa". 		
c) Aktorët e mundshëm (grupetqëlidhen me projektin dhe që ndikohen)	d) Kontributet e mundshme në projekt	
PAN-të që jetojnë në shtëpi-familjet e projektit "Shpresa" Komuniteti Institucionet publike Organizatat	MMSR Bashkia Projekti "Shpresa"	
e) Shpenzimet e llogaritura		
Shpenzimet për çdo aktivitet	Totali (mijë	Nga kjo:



2018		lekë)	Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me	Kapitale
A.1	Paga për 24 kujdestarë	13 571				13 571	
A.2	Paga për admistratorin, psikologun klinik dhe infermierin	2 900				2 900	
A.3	Kuota ushqimore	914				914	
	Shuma	17385				17385	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me	kapitale
A.1	Paga për 24 kujdestarë	13 842				13 842	
A.2	Paga për admistratorin, psikologun klinik dhe infermierin	2 958				2 958	
A.3	Kuota ushqimore	585				585	
	Shuma	17385				17385	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me	kapitale
A.1	Paga për 24 kujdestarë	14 000				14 000	
A.2	Paga për admistratorin, psikologun klinik dhe infermierin	3 100				3 100	
A.3	Kuota ushqimore	1520				1520	
	Shuma	18620				18620	
f) Periudha e zbatimit Janar – Dhjetor 2018			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i Drejtorisë së Shërbimit Social Strehimit dhe Shëndetit Publik Stafi i Drejtorisë së Financës Projekti "Shpresa" Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 34	P10.F4.O1.A2 "Asnjë Fëmijë Jashtë"	Llojet e programit: P10. Strehimi dhe Shërbimet sociale Funksioni:P10.F4.O1 Në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>"Asnjë fëmijë jashtë" është një aktivitet social-kulturor që organizohet që nga viti 2005, me rastin e festave të fundvitit. Protagonistë të këtij aktiviteti janë fëmijët e familjeve në vështirësi social-ekonomike. Gjatë vitit 2017 ky aktivitet është zhvilluar në qendër të qytetit me pjesëmarrjen e shkollave të ndryshme të qytetit dhe fëmijëve të institucioneve rezidenciale.</p> <p>Gjatë vitit 2018 e në vazhdim ky aktivitet social kulturor do të zhvillohet me rastin e festave të fundvitit me qëllim integrimin social të fëmijëve.</p> <p>Ky aktivitet përfshin të gjitha kategoritë e fëmijëve të familjeve në vështirësi të theksuara social-ekonomike, gjithashtu përfshin aktivisht PAN-të, fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptian, fëmijët e ngujuar, fëmijë të institucioneve rezidenciale, fëmijë në situatë rruge duke përfshirë edhe fëmijë nga të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër. Fëmijët përgatitendhe performojnë në fusha të ndryshme artistike si; muzikë, recitim, vegla muzikore, teatër, etj duke synuar gjithëpërfshirjen e fëmijëve në fusha të ndryshme të artit duke qenë vetë ata protagonist.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Gjithëpërfshirje e fëmijëve të familjeve në nevojë, në aktivitetet social-kulturore. • Synojmë të ndikojmë në përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve të qytetit të Shkodrës dhe familjeve tyre. • Bashkëpunim dhe mbështetje të organizatave aktive në mbrojtjen të fëmijëve që veprojnë në qytetin e Shkodrës. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerni për të prodhuar rezultate)						
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Thirrja për pjesëmarrje në "Asnjë fëmijë jashtë". ▪ Përgatitja e fëmijëve për pjesëmarrjen në "Asnjë fëmijë jashtë". ▪ Perzgjedhja e perfituesve në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër ▪ Organizimi dhe zhvillimi i eventit. ▪ Kryerja e procedurave për lëvrinim e fondit. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> ○ Përmirësimi i situatës së fëmijëve dhe familjeve në vështirësi social dhe ekonomik në qytetin e Shkodrës. ○ Gjithëpërfshirja e fëmijëve në aktivitet social kulturor. ○ Bashkëpunim i afërt dhe mbështetje e organizatave. ○ "Asnjë fëmijë jashtë", një aktivitet social – kulturor gjithëpërfshirës me pjesëmarrje aktive të fëmijëve të Bashkisë Shkodër. 						
c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dh e që ndikohen)				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Komuniteti Institucionet publike Organizatave				Bashkia Organizatave Komuniteti		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	Shpenzim për marrje qira të skenografisë	70			70	
A.2	Honorare 2 Konferencierë (2 x 7 mijë leke)	14			14	
A.3	transport	30			30	
A.4	Transmetim televiziv/montazh/foni	80			80	
A.5	Materiale promocionale, dhurata për fëmijë, Diploma (25x0.1)	63			63	
A.6	Te tjera	9			9	
Shuma		266			266	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë)	Nga kjo:			

		lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Shpenzim per marrje qera te skenografise	70			70		
A.2	Honorare 2 Konferenciere (2x7)	14			14		
A.4	transport	30			30		
A.5	Transmetim /montazh/foni	80			80		
A.6	Materiale promocionale, dhurata per femije, Diploma (25x0.1)	63			63		
A.7	Te tjera	9			9		
	Shuma	266			266		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Shpenzim per marrje qera te skenografise	70			70		
A.2	Honorare 2 Konferenciere (2x7)	14			14		
A.3	transport	30			30		
A.4	Transmetim /montazh/foni	80			80		
A.5	Materiale promocionale, dhurata per femije, Diploma (25x0.1)	68			68		
A.6	Te tjera	9			9		
	Shuma	271			271		
f) Periudha e zbatimit Nentor - Dhjetor 2018			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së shërbimit social, shëndetit publik dhe strehimit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 35	P10.F4.O1.A3 Mbështetja e Trupës muzikore të Personave me Aftësi Ndryshe	Llojet e programit: P10. Strehimi dhe Shërbimet sociale Funksioni:P10.F4.O1 Në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
<p>i. Situata</p> <p>Që nga viti 2005 në qytetin e Shkodrës zhvillon veprimtarinë e saj trupa muzikore The DOOR Albania, e vetmja në rajonin e Ballkanit. “Trupa muzikore e PAN-ve” përbëhet nga një grup të rinjsh me aftësi ndryshe, të gjithë ish nxënës të shkollës speciale “3 Dhjetori”. Për të institucionalizuar bashkëpunimin, Bashkia e Shkodrës dhe “The Door” synojnë arritjen e një marrëveshjeje bashkëpunimi me synim qëndrueshmërinë, vazhdimësinë, mbështetjen dhe nxitjen e aktivizimit të kësaj trupe si një model pozitiv i integritimit në jetën social kulturore të fëmijëve me aftësi ndryshe. Kjo trupë muzikore angazhohet në aktivitete të ndryshme që realizohen në territorin e bashkisë Shkodër, por jo vetëm. Kursi synon integrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe të cilët janë shumë të aftë në veglat frymore dhe përmes angazhimit përcjellin mesazhin : Mundësi integrimi për të gjithë. Disa prej aktiviteteve të parashikuara për pjesëmarrje gjatë vitit 2018 për Trupën muzikore PAN janë: Festa e karnavaleve Festa e Lojra Popullore fest Dita ndërkombëtare e PAK, 3 Dhjetori Asnjë fëmijë jashtë</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Synojmë promovimin dhe gjithpërfshirjen e PAN në aktivitete social-kulturore. • Synojmë sensibilizimin e familjeve të PAN-ve dhe komunitetit, për aftësitë e veçanta dhe mundësitë e kësaj kategorie • Synojmë institucionalizimin e marrëveshjes për qëndrueshmërinë e aktiviteteve të kësaj bande. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhua rrezultate)						
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përgatitja e marrëveshjes ▪ Miratimi dhe nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ▪ Zhvillimi i provave sipas një kalendari të paracaktuar gjatë gjithë vitit ▪ Angazhimi dhe përfshirja e vazhdueshme e trupës nga stafi drejtues ▪ Pjesëmarrja në aktivitetet e lartpërmendura dhe jo vetëm 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> ○ Promovimi dhe gjithpërfshirja e PAN-ve në aktivitetet social - kulturore ○ Sensibilizimi i komunitetit dhe familjeve të PAN-ve ○ Përmirësimi i cilësisë së jetës social-kulturore të PAN-ve ○ Përfshirja e personave me aftësi të kufizuar 						
c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)	d) Kontributet e mundshmenëprojekt (kush do tëkontribuojëpërkëtëprojekt, financiarisht, etj.)					
Personat me aftësi ndryshe Familjet e personave me aftësi ndryshe Komuniteti Institucionet publike Organizatata	Bashkia Organizatata Komuniteti					
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	Honorar për 1 punonjëse sociale part-time (1 x 12muaj x12 mije leke)	144			144	
A.2	Honorar për 2 inspektorët e muzikës (2 x12 muaj x 7.25 mije leke)	174			174	
A.3	Transport	37			37	
Shuma		355			355	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale



A.1	Honorar për 1 punonjëse sociale part-time (1 x 12muaj x12 mije leke)	144			144		
A.2	Honorar për 2 inspektorët e muzikës (2 x12 muaj x 7.25 mije leke)	174			174		
A.3	Transport	44			44		
	Shuma	362			362		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Honorar për 1 punonjëse sociale part-time (1 x 12muaj x12 mije leke)	144			144		
A.2	Honorar për 2 inspektorët e muzikës (2 x12 muaj x 7.25 mije leke)	174			174		
A.3	Transport	51			51		
	Shuma	369			369		
f) Periudha e zbatimit Janar – Dhjetor 2018		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së shërbimit social,shëndetit publik dhe strehimit Stafi i organizatës The Door Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					